



PADIA PËR KËRKIMIN E TRASHËGIMIT

TEZA E MASTERIT

PAULA NDROQI

EPOKA UNIVERSITY

FACULTY OF LAW AND SOCIAL SCIENCES

DEPARTMENT OF LAW

TIRANA, ALBANIA

QERSHOR 2023

PADIA PËR KËRKIMIN E TRASHËGIMIT

PAULA NDROQI

Teza e dorëzuar për plotësimin e kërkesës për titullin Master i Shkencave Juridike në
Drejtësi

EPOKA UNIVERSITY

QERSHOR

2023

FAQJA E MIRATIMIT

Emri dhe Mbiemri i studentit: Paula Ndroqi
Fakulteti: Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale
Departamenti: Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale

Tema e Diplomës: Padia për kërkimin e trashëgimit
Data e mbrojtjes: 10.07.2023

Vërtetoj që ky punim përfundimtar plotëson kriteret si Tezë Masteri për gradën Master Shkencor në Drejtësi.

Prof. Dr. Niuton Mulleti
Shefi i Departamentit

Kjo është për të vërtetuar që e kam lexuar këtë punim përfundimtar dhe se sipas mendimit tim është plotësisht i përshtatshëm, në shtrirje dhe cilësi, si temë e Masterit për titullin Master i Shkencave Juridike.

Dr. Eglantina Farruku
Supervizori

Anëtarët e Komisionit:

Titulli/ Emri & Mbiemri	Departamenti	Firma
1- Dr. Eglantina Farruku		
2- Dr. Gelande Shkurtaj		
3- Dr. Ada Güven		

PADIA PËR KËRKIMIN E TRASHËGIMIT

ABSTRAKT

Ky studim ekzaminon rrugëtimin e zhvillimit të padisë për kërkimin e trashëgimisë në Shqipëri, Itali dhe në rajon. Për shkak të një mungese të gjatë të dijes, diversitetit kulturor dhe informacionit lidhur me këtë institut, padia për kërkimin e trashëgimisë është e një rëndesie të veçantë. Trashëgimia si institut është i trajtueshëm për impaktin social dhe ligjor që ka, kjo për arsye se trashëgimia në çdo formë prek në menyrë të drejtëpërdrejtë ose indirekt të drejtat e trashëgimtarëve aktual apo të ardhshëm.

Në vetvete padia për kërkimin e trashëgimisë si mjet për mbrojtjen e të drejtave të trashëgimtarëve, përbën një ndër paditë me dimensione nga më të ndryshmet, e trajtuar dhe e implementuar në forma të ndryshme në varësi të zhvillimit historik dhe kulturor të secilit shtet.

Synimi i këtij studimi është njohja e padisë për trashëgimin si një mekanizëm mbrojtës i të drejtës ligjore dhe trashëgimore e trashëgimtarëve si dhe dhënien e një zhvillimi që ka pësuar ngritja e kësaj padie nga periudha e të drejtës romake e deri në ditët e sotme. Krahas këtij trajtimi, synimi qëndron dhe në trajtimin e aspektit procedural të kësaj padie duke qenë se dispozitat sqaruese për mënyrën dhe trajtimin nga gjykata të këtyre padive, është e limituar. Një qasje tjetër e përfshirë në këtë punim, është gjithashtu dhe aspekti krahasimor me legjislacionin italian, gjerman, francez dhe grek, nga është implementuar edhe Kodi Civil shqiptar për të dhënë një pikpamje të mënyrës së trajtimit në vende të tjera krahas Shqipërisë.

Fjalët kyçe: padi për kërkimin e trashëgimit, gjykatë, trashëgimi, mekanizëm mbrojtës, zhvillim historik dhe krahasimor.

LAWSUIT ON SUCCESSION CLAIM

ABSTRACT

This study examines the succession claim process in Albania, Italy and the region. Due to a long lack of knowledge, cultural diversity and information about this institute, the lawsuit for the succession claim is of particular importance. Inheritance as an institution is treated for the social and legal impact that it has because succession in any form either directly or indirectly affects the rights of current or future heirs.

The lawsuit on the succession claim is an instrument that provides protection for the rights that the heirs have. This is the reason why this lawsuit is implemented differently depending on each country's legislation.

The aim of this study is to recognize the importance of this lawsuit and provide insight on the necessity of the proper court proceedings regarding this claim. It also emphasizes the origin of this lawsuit and the transition that these proceedings have foregone.

Moreover, included in this paper is also the comparative view with the Italian, German, French and Greek legislation which have had a significant influence on the implementation of the Albanian Civil Code, in order to provide a different prospect with those countries alongside the development of the modern Albanian Civil Code.

Key Words: Lawsuit on succession, court, succession (inheritance), protective instrument, historical and comparative development.

FALËNDERIME

Mund të kesh shumë arritje në jetë nëse ke vendosmërinë dhe personat e duhur që të suportojnë. Duke ditur këtë, dëshiroj të falënderoj të gjithë ata që bënë të mundur që unë të përmbush qëllimet e mia dhe bënë këtë rrugëtim të mundshëm, të bukur dhe të paharrueshëm.

Së pari dëshiroj të falënderoj profesoret Dr. Eglantina Farrukun, si pedagogja kryesuese e temës së diplomimit, për suportin e saj maksimal gjatë gjithë kësaj rruge sa të bukur aq dhe ngarkuese. Suporti i saj gjatë gjithë këtij procesi ka qënë i pazëvendueshëm dhe ndihmesa e saj ishte e jashtëzakonshme. Gjithashtu dëshiroj të falënderoj profesoret Dr. Gelanda Shkurtaç, për vitet e palodhura të leksioneve në të Drejtën Civile. Pasioni i saj për këtë fushë të së drejtës, më bëri të përfshihesha me një interes më të madh për të Drejtën dhe Procedurën Civile e më tepër institutin e trashëgimisë ku unë vendosa të bëj studimin tim final. Ndihem e vërtetë e vlerësuar dhe e lumtur që kam pasur mundësinë të mësoj dhe të krijoj punimet e mia nën influencën e profesoreve dhe çdo profesori dhe profesore tjetër këto pesë vite të cilët na mësuat të jemi më të denjë profesionalisht dhe mbi të gjitha nga ana sociale. Gjithashtu dua të falënderoj për zemërsisht profesor Gentjan Skara për përkushtimin absolut që ka ofruar gjatë periudhës si lektor i studentëve të Drejtësisë dhe për çdo leksion të paharrueshëm dhe informativ e mbi të gjitha gjithëpërfshirës që na ka dhënë. Falënderim shkon dhe për ndihmën jashtë shkollore që profesori është munduar të na ofrojë dhe ja ka dalë më së miri.

Një falënderim i veçantë shkon për familjen time, si personat që nuk reshtën kurrë së besuari tek aftësitë e mia dhe kur unë ndonjëherë harroja. Një falënderim i shkon për mësimet që më ofruan që në momentin kur mësova të kuptoj e që më mësuat se me punë, modesti dhe mirësjellje çdo gjë mund të arrihet. Krahas pjestarëve të tjerë të familjes, këtë punim ja dedikoj mamit tim si tifozja më e madhe e imja dhe frymëzimi im më i madh për të arritur suksese të mëdha. Pa të nuk do të isha gjysma e asaj për të cilën krenohem sot, vetes time!

Gjithashtu, dua të përfshijë në këtë falënderim, gjyshen time e cila dhe pse nuk është më, ishte mbështetësja më e madhe e rrugëtimit tim dhe që uroj që me këtë punim të kem arritur pritshmëritë që ajo kishte për mua.

Së fundmi, por jo më pak të rëndësishëm, dëshiroj të falënderoj çdo bashkëstudent timin veçanërisht studenten Gea Alibeaj, për çdo moment lumturie, stresi përpara provimeve, dhe momente kënaqësie pas çdo arritjeje. Kontributi social dhe akademik i tyre ka qënë e do mbetet i pazëvendësueshëm.

DEKLARATË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar tërësisht prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë më parë përpara një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri apo pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk mban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveçse rasteve të cituara dhe referuara.

Paula NDROQI

Datë: 19 Qershor 2023

TABLE OF CONTENTS

FAQJA E MIRATIMIT	II
ABSTRAKT	III
ABSTRACT	IV
FALËNDERIME	V
DEKLARATË	VII
TABLE OF CONTENTS	VIII
LISTA E SHKURTIMEVE	X
1. HYRJE	1
1.1. Instituti i trashëgimisë	1
1.2. Qëllimi i punimit dhe pyetje kërkimore	2
1.3 Metodologjia	2
1.4. Struktura	4
2. INSTITUTI I TRASHËGIMISË DHE PADIA PËR KËRKIMIN E TRASHËGIMIT	5
2.1 Trashëgimia si institut i të drejtës civile	5
2.2 Sistemi i fitimit të trashëgimit	6
2.3 Padia për kërkimin e trashëgimisë si mjete mbrojtës i pasurisë trashëgimore	7
3. PADIA PËR KËRKIMIN E TRASHËGIMIT	9
3.1 Padia për kërkimin e trashëgimit e trajtuar në të Drejtën Romake	9
3.2 Mjetet mbrojtëse të të drejtës së trashëgimisë për periudhën kohore ekzistuese deri në momentin e legjitimitetit të Kodit Civil shqiptar të vitit 1928.	10
3.3 Padia për kërkimin e trashëgimit sipas Kodit Civil të vitit 1928.	11

3.4	Padia për kërkimin e trashëgimit sipas përcaktimeve të Dekretit Nr.1892, datë 05.07.1954 “Mbi trashëgiminë”.	12
3.5	Padia për kërkimin e trashëgimit gjatë periudhës së Republikës Popullore Socialiste Shqiptare, 1982.	13
3.5.1	Historik i fillimit modern të trashëgimisë dhe padisë për trashëgiminë.	17
3.6	Padia për kërkimin e trashëgimit.	17
3.6.1	Legjitimimi aktiv.	18
3.7.1.1	Personat e ligjshëm për të ngritur padinë:	21
3.7.2.	Legjitimiteti pasiv.	23
3.7.3.	Praktika lidhur me nenin 349 dhe vijues për padinë për trashëgimin.	25
3.7.4	Objekti i padisë.	26
3.7.5.	Problematikat në praktikën gjyqësore lidhur me përcaktimin e objektit për padinë për kërkimin e trashëgimit.	28
3.7.6	Gjykatat kompetente për gjykimin e padisë për kërkimin e trashëgimit.	30
4.	ASPEKTE KRAHASIMORE TË VENDIT TONË ME VENDET E RAJONIT	31
4.1	Padia për kërkimin e trashëgimit sipas legjislacionit Italian	31
4.1.2.	Padia për kërkimin e trashëgimit italian krahasuar me atë shqiptar.	32
4.3	Padia për kërkimin e trashëgimit sipas legjislacionit gjerman.	35
4.3.1.	Padia për kërkimin e trashëgimit në aspektin krahasimor me Shqipërinë.	37
4.4	Instituti i trashëgimisë sipas legjislacionit grek.	38
4.4.1	Aspekte krahasimore me legjislacionin shqiptar.	39
	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.	41
	REFERENCES	44

LISTA E SHKURTIMEVE

- K.C** Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
R.P Republikë
R.P.S.SH Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë
P.SH Për shembull

1. HYRJE

1.1. Instituti i trashëgimisë

Instituti i trashëgimisë është një prej instituteve më të rëndësishme të të Drejtës Civile moderne sindomos në Shqipëri. E drejta e pronësisë është një prej bazave të krijimit të demokracisë pasi mungesa e të drejtës së posedimit të një pronësie në mënyrë të lirë, një ndër faktorët që shpie në kolaps të ekzistencës së demokracisë.

Vetë trashëgimia në vendin tonë, ka kaluar një periudhë tranzitore tepër të madhe, që në momentin e njohjes me një institut të tillë e në vazhdimësi. Padia për kërkimin e trashëgimit ka ekzistuar që në periudhën e të drejtës romake, ku përdorej për të bërë ndarjen e pasurisë ndërmjet personave trashëgimtarë të familjes. Në Shqipëri ekzistenca e padisë kërkimin e trashëgimit është shfaqur në linja më patriarkale pasi në të kanë pasur një influencë të bollshme dhe kanunet siç ishte Kanuni i Lekë Dukagjinit apo Kanuni i Labërisë. Ndarja dhe njohja e pronësisë edhe pse patriarkale, bëri hapat e parë të krijimit dhe njohjes së padisë për kërkimin e trashëgimit.

Gjatë periudhës komuniste, praktika nuk e njihnte më si mjet mbrojtës pasi në atë periudhë u prezantua për herë të parë dhe shtetëzimi i pronësisë private, si rrjedhojë njerëzit nuk kishin një pronësi të trashëguar që mund t'u mohojë dhe që të ngrihet në vijim në gjykatë.

Padia për kërkimin e trashëgimit përbën faktorin më të madh të konflikteve bashkëpronësore dhe një prej problematikave të praktikës gjyqësore. Ky institut ka hasur pengesa të vazhdueshme pasi krahas praktikës gjyqësore të gabuar, ka pasur dhe mungesë të saktësisë të këtij mjeti në objektin e padisë. Si rrjedhojë, shpesh është ngritur një padi rivendikimi me synimin për të qenë një padi për kërkimin e trashëgimit.

Në marrëdhënie me vendet e rajonit do të shihet se Italia ka të njëjtën qasje me Shqipërinë në krahasim me vendet e tjera të cilët kanë një trajtim të veçantë dhe më të gjerë të këtij instituti. Qëllimi i legjislatorit në çdo moment është mbrojtja e të drejtës trashëgimore të trashëgimtarëve dhe si rrjedhojë duhet të mundesojë çdo mjet ligjor.

1.2. Qëllimi i punimit dhe pyetje kërkimore

E drejta e trashëgimisë është e lidhur me të drejtën e pronësisë pasi një nga mënyrat e fitimit të pasurisë është nëpërmjet institutit të trashëgimisë (ligjor apo testamentar). Qëllimi kryesor i këtij punimi do të jetë vëzhgimi i rrugëtimit të padisë për kërkimin e trashëgimit që nga momenti i njohjes së saj e deri në ditët e sotme. Ka qëllim që krahas rrugëtimit të ofrojë një qasje krahasimore me vendet e rajonit si vende frymëzuese për implementimin e legjislacionit civil modern shqiptar.

Studimi synon të japë përgjigje pyetjeve vijuese:

- Si është trajtuar padia për kërkimin e trashëgimit dhe cilat ishin elementet dalluese të saj?
- Si trajtohet kjo padi në vendin tonë dhe si trajtohet nga vendet e rajonit?
- Sa e saktë ka qene praktika gjyqësore?
- Si trajtohet padia për kërkimin e trashëgimit nga Italia, Greqia, Gjermania dhe

Franca?

Nevoja për ngritjen e këtyre pyetjeve ka lindur si rezultat i problematikave që krijohen, pasi shpesh herë padia për kërkimin e trashëgimit, keqinterpretohet dhe ngrihet si një padi rivendikimi. Ndaj dhe ngritja e këtyre pyetjeve është e rëndësishme, në mënyrë që të ofrohet një tablo më e qartë e kësaj padie.

Lidhur me rajonin, nevoja për ngritjen e këtyre pyetjeve lidhet me rëndësinë e krijimit të një qasjeje krahasuese për të parë se si trajtohet dhe për të evidentuar procedurën që ndjekin këto vende krahasuar me Shqipërinë.

1.3 Metodologjia

Metoda e përzgjedhur për këtë punim është metoda cilësore. Kjo metodë pëfshin marrjen dhe analizimin e të dhënave jo numerike, për të kuptuar koncepte, opinione apo eksperiencë.

Mund të përdoret për të përfituar njohuri të thella lidhur me një problematikë apo fenomen dhe të gjenerojë informacion të ri për një punë kërkimore. Ky punim është realizuar duke u bazuar në burimet dytësore të cilat përfshijnë Ligji Nr.7850, datë 29.7.1994 KODI CIVIL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (ndryshuar me Ligjin Nr. 113/2016, datë 3.11.2016), tekste ligjore, materiale ligjore ndërkombëtare, praktika gjyqësore, botime përmbledhjesh ligjore. Për një analizë më të gjerë metoda e përdorur është metoda krahasimore ndërmjet legjislacioneve ndërkombëtare për trajtimin e padisë për kërkimin e trashëgimit për të ofruar një qasje më përfshirëse.

Burimet dytësore të përdorura:

- Legjislacioni shqiptar: Ligji Nr. Nr.7850, datë 29.7.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar me Ligjin Nr. 113/2016, datë 3.11.2016) i cili shërben si burim primar për analizën e institutit të trashëgimisë dhe padisë për kërkimin e trashëgimit për të patur një qasje të saktë të arsytimit ligjor lidhur me kuptimin e instituteve. Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar me Ligjin Nr. 38/2017, datë 30.3.2017), shërben për të shpejguar aspektin procedural dhe trajtimin ligjor të që legjislatori jep për të bërë një krahasim më të saktë me aspektin procedural të Italisë, Greqisë, Francës dhe Gjermanisë.
- Tekste Ligjore: Materiale të botuara nga shkolla e Magjistraturës, akademikë e magjistratë, materiale të studiuësve doktrinalë do të përdoren për të sqaruar pikpamjen doktrinale të padisë për të konceptuar më qartë krijimin dhe zhvillimin e këtij instituti.
- Praktika gjyqësore: Materialet referuese lidhur me praktikën gjyqësore do të bazohen kryesisht në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë si referim për unifikimin e praktikës lidhur me trajtimin e padisë nga gjykatat e shkallave me të ulëta. Krahas vendimeve unifikuese, materiali do të bazohet gjithashtu dhe në vendimarrjen që Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka dhënë ndër vite për çështje lidhur me padinë për kërkimin e trashëgimit.

Ky punim kërkimor është një kombinim i burimeve dytësore sëbashku me një aspekt zhvillues dhe krahasues, dhe ka si qëllim analizimin e padisë për kërkimin e trashëgimit në tërësi si një mjet mbrojtës kryesor i të drejtave trashëgimore.

1.4. Struktura

Kapitulli 1, si hyrje jep një qasje fillestare lidhur me tematikën që trajtohet dhe qëllimin që ky punim synon të përcjellë. Kapitulli 2, pëfshin historikun e zhvillimit të padisë për kërkimin e trashëgimit duke e analizuar në mënyrë koherente për të kuptuar më qartë ndryshimet e pësuara në dispozita. Kapitulli 3, tregon të gjithë rëndësinë e kësaj padie, elementët e saj si dhe problematikat që hasen sot në praktikën gjyqësore. Kapituli 4, bën krahasimin midis legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar, e më specifikisht Italisë, Gjermanisë, Francës dhe Greqisë. Në kapitullin e 5, janë bërë konkluzionet dhe janë dhënë rekomandime të mëtejshme.

2. INSTITUTI I TRASHËGIMISË DHE PADIA PËR KËRKIMIN E TRASHËGIMIT

2.1 Trashëgimia si institut i të drejtës civile

Trashëgimia si një institut universal i të drejtës civile, ka një rëndësi të veçantë pasi nëpërmjet këtij instituti përcaktohet shpërndarja e pronësisë tek personat e listuar ligjërisht apo të përcaktuar në mënyrë testamentare. Një përkufizim universal i trashëgimisë do të ishte: “*shpërndarja e pronësisë së trashëgimlënësit (të vdekurit), midis personave të listuar me ligj dhe/ose testament*” (Principle of Universal Succession, 2023, pp. 1-3)

Ky përkufizim kryesisht është pranuar nga të gjithë shtetet por çdo shtet ka kryer përshtatjet me Kushtetutën dhe Ligjin vendas.

Ligji shqiptar, trashëgiminë e njeh si një formë e kalimit ose fitimit të pronësisë dhe e përkufizon në nenin 316 të Kodit Civil Shqiptar si: “*Kalimi me ligj ose testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur (trashëgimlënësit), një ose më shumë personave (trashëgimtare), sipas rregullave të caktuara në këtë Kod*” (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2016, p. 62). Kodi Civil grek në nenin 983 të saj e përkufizon trashëgiminë si: “*Kalimin e pasurisë së trashëgimlënësit tek trashëgimtarët e tij*” (Αστικός Κώδικας, 1946, p. 291). Kodi Civil italian në nenin 456 të saj shprehet lidhur me trashëgiminë se: “*Trashëgimia fillon në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, në vendbanimin e fundit të tij*” (Codice Civile, 1942). Teoria që pranohet universalisht nga Italia, Greqia dhe Shqipëria është ekzaktësisht prezenca e trashëgimtarëve si palë kryesore e përfitimit të të drejtave që trashëgimtari kishte si dhe vdekjen e këtij të fundit. Këto tre shtete si shtetet që kanë përshtatjen më të madhe të legjislacioneve civile, quajnë këtë moment si momentin kyç të nisjes së përfitimit nga këto të drejta.

Megjithatë, legjislacionet nuk kufizohen vetëm tek pasuritë e luajtshme apo të paluajtëshme kur flasin për kalimin e ketyre të drejtave. Paralelisht, njihet jo vetëm kalimi i të drejtave por dhe kalimi i detyrimeve juridike civile. Me vdekjen e trashëgimlënësit, ligji krijon hapsira që trashëgimtarët e tij të trashëgojnë dhe detyrimet e tij qoftë ato financiare ose të tjera.

Në kontekst më të ngushtë, nga çfarë shprehur më sipër kuptohet se në rastin e trashëgimisë, bëhet zëvendësimi i plotë i të drejtave që trashëgimlënësi kishte në momentin që ai i posedonte këto të drejta dhe që në vijim lë si trashëgimi pasurinë e tij (i vdekuri), drejt personit që gëzon këtë të fundit pas vdekjes së trashëgimlënësit (trashëgimtari). Për më tepër, në bazë të kësaj forme fitimi apo suksedimi, trashëgimtari apo trashëgimtarët fitojnë të drejta nga më të larmishmet përfshirë këtu të drejtën e pronësisë, të drejtën lidhur me detyrimin, dhe çdo të drejtë tjetër që mund të lidhet drejtpërdrejtë apo indirekt me pasurinë e fituar, këtu përfshirë dhe pasurinë të cilën trashëgimtarët mund të mos kenë pasur dijeni që ekzistonte.

Nga çfarë është thënë më sipër, konkludohet fakti se me çeljen e trashëgimisë arrihet të krijohet një set rregullash të reja juridike të pasurisë dhe përgjegjësisë së të drejtave pasusore që ka lënë në trashëgim trashëgimlënësi. Ky tranzicion, zhvesh nga këto të drejta si pasojë e vdekjes, trashëgimlënësin dhe vesh me përgjegjësi dhe të drejta, trashëgimtarin ose trashëgimtarët.

2.2 Sistemi i fitimit të trashëgimit

Sistemi i fitimit të trashëgimisë pranohet kryesisht nga legjislacionet që janë influencuar nga ligji civil italian. Këto legjislacione njohin pranimin e sistemit të fitimit të trashëgimisë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit (Codice Civile, 1942). Pra, nga përkufizimi i mësipërm, kuptohet se trashëgimtari është posedues i pasurisë pa qenë nevoja të kryejë veprime konkrete për të hyrë në këtë posedim pasi në momentin e çeljes së trashëgimisë, trashëgimtari fiton automatikisht posedimin mbi pasurinë.

Kodi Civil shqiptar ka sjellë një risi të veçantë nëpërmjet nenit 331 e cila lidhet drejtpërdrejtë me sistemin e fitimit të trashëgimisë. Ky nen shpreh momentin e çeljes së trashëgimisë dhe të drejtën që trashëgimtari ka për të poseduar sendin ose pronësinë e trashëgimisë pa pasur nevojë të “vërë dorë mbi to” ose të kryejë ndonjë veprim specifik për të poseduar atë. Lidhur me këtë qëndrim, ngrihen dy problematika:

- A. Problemi që lidhet me fitimin e pasurisë nëpërmjet trashëgimisë ligjore;
- B. Problemi lidhur me posedimin e sendit nga trashëgimlënësi në kohën e vdekjes.

Për problematikën e parë që shtrohet, legjislacioni shqiptar dhe doktrina ofrojnë zgjidhjen e shprehur më sipër, pra mjafton si moment njohës çelja e trashëgimisë që vjen me vdekjen e trashëgimlënësit. Momenti kur padia për kërkimin e trashëgimisë krijon rëndësi për doktrinën ligjore është momenti që lidhet me problemin e dytë të ngritur. Kjo ndodh sepse si problematikë krijon më tepër shqetësim pasi ngre një sërë pengesash ligjore lidhur me mbrojtjen trashëgimore menjëherë pas vdekjes së trashëgimlënësit si dhe njëkohësisht me zgjidhjen e problemeve që praktika krijon për mbrojtjen. Nëpërmjet të drejtës që i është dhënë trashëgimtarit për të poseduar sendin menjëherë pas vdekjes së trashëgimlënësit, neni 331 shprehimisht i jep zgjidhje problematikës së mësipërme duke u shprehur si vijon: *“Me çeljen e trashëgimit, trashëgimtarit i kalon edhe posedimi i trashëgimlënësit mbi pasurinë trashëgimore, pa qenë nevoja për të vënë dorë mbi atë”* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2016). Që në hartimin e kësaj dispozite, legjislatori shpejton se ligjërisht trashëgimtari futet menjëherë në posedim të pasurisë së trashëguar që në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit dhe si rrjedhojë kjo liri i jep mundësinë trashëgimtarit ose trashëgimtarëve që në momentin e ekzistencës së njohjes së faktit të posedimit të sendit më anë të çeljes së trashëgimisë, ka të drejtën të kërkojë kthimin e një sendi që ka fituar ligjërisht nga pasuria trashëgimore. Këtë procedurë legjislacioni e ofron me anë të mekanizmit të padisë për kërkimin e trashëgimisë dhe padisë së rivendikimit.

2.3 Padia për kërkimin e trashëgimisë si mjeti mbrojtës i pasurisë trashëgimore

Instituti i trashëgimisë vendos si mjet mbrojtës për të drejtat që rrjedhin nga trashëgimia, padinë për kërkimin e trashëgimisë. Në vitin 2019, sipas statistikave të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë, në Shqipëri, paditë për kërkimin e trashëgimisë përbënte ndër 10 (dhjetë) paditë me të ngritura në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe kjo për arsye se me zhvillimin dhe evolimin historik si në Shqipëri dhe në vende të tjera të rajonit, trashëgimtarët u njohën dhe u prekën më tepër me të drejtat që ligji i ofron për mbrojtjen e të drejtës posedimore ndaj sendit të trashëguar. Kodi Civil Shqiptar i jep përkufizim termit “padi për kërkimin e trashëgimisë” në nenin 349 të saj, i cili është si vijon: *“Trashëgimtari mund të kërkojë me padi nga kushdo që posedon tërësisht ose pjesërisht pasurinë trashëgimore, njohjen e tij si trashëgimtar dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore dhe të pasurisë së fituar me anë të saj, sipas rregullave mbi posedimin me mirëbesim dhe me keqbesim”* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2016, p. 67). Sipas kësaj dispozite, trashëgimtari në rolin e paditësit, legjitimohet të ngrejë padinë për kërkimin e trashëgimit kur kjo e drejtë nuk i është realizuar plotësisht apo pjesërisht dhe sendi nuk i është vënë në posedim të plotë apo të pjesshëm.

Në nenin 350 të Kodit Civil shqiptar, karakteri i padisë për kërkimin e trashëgimisë ndahet në 3 (tre) aspekte kryesore:

- Karakter universal (të përgjithshëm), e cila përfshin mbajtjen e njohjes së të gjithë trashëgimisë dhe të gjithë sendeve të përfshira dhe çdo të drejtë që rrjedh posaçërisht nga trashëgimi (Shkolla e Magjistraturës, 2010, p. 8);
- Karakter miks, është një padi me karakter që mund të ngrihet ndaj çdo personi pretendues i trashëgimisë e tërësi ose në lidhje me paditë reale që lidhen me personat që pretendojnë se janë trashëgimtarë;
- Karakter personal, e cila ngrihet për paditë kur pala e paditur pretendon se është trashëgimtar apo trashëgimtare e një të drejte detyrimore.

3. PADIA PËR KËRKIMIN E TRASHËGIMIT

3.1 Padia për kërkimin e trashëgimit e trajtuar në të Drejtën Romake

Ashtu si dhe në periudhën e shekullit XXI dhe në periudhën e të drejtës romake, padia për kërkimin e trashëgimit u krijua si një mjet mbrojtës ndaj pasurisë trashëgimore dhe në dobi të trashëgimtarëve legjitim të kësaj trashëgimie. Në periudhën e të drejtës romake ekzistonin disa mekanizma për mbrojtjen e të drejtës trashëgimore të cilat ndaheshin në realizimin kryesisht ose të vetë të drejtës së trashëgimit ose në realizimin e disa të drejtave si dhe ndarjen e masës trashëgimore mes bashkëtrashëgimtarëve (Puhan, 2015, p. 433).

Në periudhën e të drejtës romake padia për kërkimin e trashëgimit njihej me termin latin *“hereditatis petitio”* e cila përkthehet si *“veprimi real me anë të të cilit trashëgimtarit me të drejta trashëgimore universale ose me titull universal - si paditës - i kërkon gjykatës njohjen e statutit të trashëgimtarit dhe detyrimin e të paditurit, i cili pretendon se ai ka titullin trashëgimtar dhe mban një pjesë ose të gjitha sendet që i përkasin trashëgimisë trashëgimore, për t'i kthyer mallin në fjalë”* (Petition for an Inheritance, a way to protect hereditary rights, 2009, p. 1). Kjo padi ngrihej për çdo rast kur trashëgimtarit ose disa prej trashëgimtarëve u ishte mohuar e drejta e tyre për të qenë pjesmarrës në trashëgimi. Për rastet kur provohej prej ktyre të fundit se ishin pjesë faktike e trashëgimisë apo posedues të atij sendi trashëgimor, atëherë gjykata i ofronte mundësinë që të merrej ose e gjitha pjesë e trashëgimisë ose ajo pjesë për të cilën pretendohesh se ishte mohuar e drejta e tyre (Mandro, 1998, p. 333).

Me zhvillimin e qytetërimit, kjo padi ndryshoi në thelbin e saj dhe shihej jo më vetëm si një padi reale por si një padi personale. Kjo vinte si rezultat i ndryshimit të kërkesës që bëhej në këtë padi e cila nuk përfshinte më vetëm të drejtën e mohuar por dhe të drejtat të cilat rridhnin nga posedimi i kësaj pasurie siç mund të ishin p.sh: kërkimi i të ardhurave që vinin nga pasuria trashëgimore, pagesën e dëmshpërblimeve të cilat bëheshin direkt nga i padituri.

Në të drejtën romake, ekzistonte rregulli i kompesimit të paditësit për rastet kur pasuria e poseduar shitej nga i padituri në mirëbesim përpara paraqitjes së padisë në gjykatë. Si rrjedhojë, kur gjykata i jepte të drejtën e fitimit të posedimit palës paditëse, pala e paditur ishte e detyruar të shpërblente paditësin vetëm pjesën e pëfituar nga shitja e kësaj pasurie apo sendi (Droit prive romain, II, Obligations, Successions, Procedure, "CJR", 1991, p. 231). Në periudhën e të drejtës romake, rëndësi të veçantë kishte fakti që paditë për kërkimin e trashëgimit nuk parashkruheshin. Arsyeja e mosparashkrimit të kësaj padie ishte se trashëgimia ishte e përhershme, pra nëse trashëgimtari ishte njëherë trashëgimtar, trashëgimtar do mbetej gjithmonë (Padia për kërkimin e trashëgimit dhe praktika gjyqësore në lidhje me të., 2022, p. 6). Për realizimin e të drejtave personale dhe për ndarjen e pasurisë bashkëtrashëgimore, trashëgimtari zotëronte të gjitha paditë të cilat i takonin trashëgimlënësit kur ishte gjallë, dhe për rastin e ndarjes ndërmjet bashkë-trashëgimtarëve, rregullat dhe paditë përcaktoheshin sipas ligjit të XII tabelave. Ligji i XII tabelave bënte ndarjen e detajuar dhe të saktë të pasurisë trashëgimore ndërmjet trashëgimtarëve legjitim (E Drejta Romake, 2015, p. 434).

3.2 Mjetet mbrojtëse të të drejtës së trashëgimisë për periudhën kohore ekzistuese deri në momentin e legjitimitetit të Kodit Civil shqiptar të vitit 1928.

Instituti i trashëgimisë në të drejtën civile shqiptare historikisht është zhvilluar në mënyrë paralele me të drejtën e pronësisë. Është e drejta pronësisë që ka krijuar vazhdimsinë e marrëdhënies me këtë institut për shkak të objektit që mbart, i cili është kalimi pikërisht i pronësisë nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët e tij.

Pas të drejtës romake, shekuj në vijim padia për trashëgiminë në Shqipëri u influencua natyrisht dhe nga pushtimi otoman dhe ligjet e tyre përkatëse. Mjetet mbrojtëse ndaj trashëgimisë dhe të drejtave mbi to rregulloheshin jo vetëm nga këto ligje por dhe nga të drejtat zakonore, të cilat ndryshonin në bazë të krahinave në të cilat këto zakone ekzistonin. Dy influencat më të mëdha për të drejtën zakonore shqiptare janë “Kanuni i Lekë Dukagjinit” dhe “Kanuni i Labërisë” të cilat në filozofi ishin të ngjashme pasi influencën më të madhe kanunet shqiptare e kanë marrë pikërisht nga Kanuni i Lekë Dukagjinit.

Kryesisht këto padi sipas ketyre kanuneve, ishin të trajtuara dhe pranoheshin ose mohoheshin nga organe të ngjashme me gjykatat e sotme. Gjykata e kësaj perudhe përbëhej nga “pleq” dhe quhej “Gjyqi i Pleqve” (E Drejta Zakonore Shqiptare, 1989, pp. 145-149). Ky organ ishte krijuar për të mbrojtur dhe për të dhënë të drejtat që buronin nga trashëgimia të të gjithë

atyre që pretendonin pronësi mbi një send. “Pleqtë” caktoheshin jo vetëm për problematika lidhur me trashëgiminë por këto kanune i caktonin këta të fundit dhe për të zgjidhur mosmarrëveshje të ndryshme.

Kështu, për ndarjen e pasurisë trashëgimore caktohej vëllai më i madh ose një kushëri ose një fqinj. Megjithatë vërehet qartë që kjo alternativë zgjidhjeje ishte e prirur për problematika për shkak se secili nga anëtarët e sipërpërmendur kishte tendencat për një vendimarrje subjektive ose për një vendimarrje që mund të dukej objektive për ta por në fakt ishte e papërshtatshme për personat ndaj të cilëve po bëhej kjo ndarje pasurie (E drejta zakonore e labërisë në planin krahasues, 1994).

Në vitin 1928, influencë ligjore në vendin tonë ka pasur periudha otomane dhe ai element dallues për këtë periudhë si dhe që përbën emërues të përbashkët për të gjitha periudhat si paraardhëse dhe pasardhëse, është pikërisht fakti që këto padi ngriheshin nga personat ose trashëgimtarët që pretendonin se ishin të prekur dhe u ishte mohuar e drejta e të qenurit trashëgimtar. Një element i veçantë është barra e provës. Si barrë prove u takonte trashëgimtarëve paditës se provonin se ishin trashëgimtarë dhe mënyrën e fitimit të pasurisë së tyre.

3.3 Padia për kërkimin e trashëgimit sipas Kodit Civil të vitit 1928.

Në 1 (një) dhjetor të vitit 1928 u miratua për herë të parë në Republikën e Shqipërisë, statuti themeltar i Mbretërisë Shqiptare. Ky statut vendosi Shqiperinë si një Mbretëri Parlamentare me në krye të vendit Mbretin Zog dhe një sistem njëdhomesh. Në 1 (një) prill 1929, Shqipëria miratoi Kodin e ri Civil i cili në risinë e saj solli një shkëputje të plotë nga periudha otomane e cila kishte zënë rrënjë të forta deri në atë periudhë dhe krijoi një tërësi dispozitash të reja të frymëzuara nga perëndimi më i avancuar siç ishte kryesisht Franca, Gjermania, Italia dhe një influencë e vogël nga Zvicra. Në këtë Kod të ri Civil, padia për kërkimin e trashëgimisë trajtohej në një formë tjetër pasi vetë ajo nuk parashikohej si mjet për mbrojtjen e të drejtave trashëgimore (Kodi Civil Shqiptar, 1929). Procedurialisht, në vend të kësaj padie, njihej padia për pjestimin gjyqësor të trashëgimit parashikuar në nenet 358 deri 370 në shtojcën e dytë të Kodit të Procedurës Civile (Vendim Nr. 73, datë 16.06.1931, Gjyqi i Diktimit, 1931). Praktika që ndiqej për rastet kur trashëgimtarëve u mohoj e drejta e trashëgimit ishte nëpërmjet nisjes së procedurës nga ana e një noteri të caktuar nga gjykata e rrethit ku do të bëhej përpjestimi i trashëgimisë. Noteri mbante një procesverbal të cilin e plotësonte dhe më pas e dërgonte në kryesekretarinë e gjykatës për njëhësim. Pjestimi i pasurisë bëhej në mënyrë

të barabartë ndërmjet bashkëtrashëgimtarëve dhe ky pjestim caktohej me short dhe për të mbahej gjithashtu një procesverbal ku caktohej vlera e akt-pjestimit. Nëse sipas akt-pjestimit pasuria kishte një vlerë më të ulët se 2500 (dy mijë e pesëqind) franga ari, atëherë padia ngrihej përpara gjykatësit fillor ose përpara gjykatës kolegjiale, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 360 të Kodit të Procedurës Civile. Ndonëse padia për kërkimin e trashëgimit nuk ishte e parashikuar në Kodin Civil të vitit 1929, ky i fundit ofronte mjete të tjera për të garantuar mbrojtjen e të drejtave absolute trashëgimore. Krahas padisë së përpjestimit të trashëgimisë, një tjetër mjet i ofruar nga legjislacioni i kohës ishte dhe padia për prishjen e pjestimit. Kjo padie ngrihej për rastet kur ndarja e pasurisë ishte bërë nën ndikimin e kanosjes (dhunës) ose mashtrimit dhe kur njëri ose disa nga trashëgimtarët provonte se i ishte mohuar me tepër se $\frac{1}{4}$ e pasurisë dhe ishin dëmtuar nga ky mohim një ose më shumë trashëgimtare.

Qëllimi i kësaj padie ishte përseritja e përpjestimit të pasurisë trashëgimore me qëllim të ndarjes së barabartë të pasurisë.

3.4 Padia për kërkimin e trashëgimit sipas përcaktimeve të Dekretit Nr.1892, datë 05.07.1954 “Mbi trashëgiminë”.

Dekreti i miratuar në vitin 1954 “Mbi trashëgiminë” në filozofinë e saj kishte thelbin e njëjtë njësoj si përgjatë gjithë zhvillimit historik të padisë për trashëgimin. Ky dekret rregullon ndër të tjera dhe këtë padie si mjet mbrojtës ndaj të drejtës që trashëgimtari ka për posedimin e pasurisë të trashëguar. Neni 19 shprehet: *“Trashëgimtari ka të drejtë të ngrejë padi kundër personit që mban pasurinë si trashëgimtar për t’iu njohur e drejta trashëgimore dhe për t’iu dorëzuar pasuria trashëgimore, ose pasuria e fituar me anë të kësaj, sipas rregullave mbi poseduesin me mirëbesim dhe keqbesim”* (Dekret Nr.1892 "Mbi Trashëgiminë", 1954). Në strukturim kjo dispozitë ndryshon nga mënyra e formulimit që shteti shqiptar i ka bërë në vitet paraardhëse por në nocion qëndron i njëjtë. Elementët e tjerë që qëndrojnë të njëjtë janë kryesisht paditësi, i padituri dhe objekti i padisë. Paditësi mbetet po personi i cili pretendon se i është mohuar pasuria e trashëguar. Të paditur konsideroheshin të gjithë personat që posedonin pasurinë nën statusin e trashëgimtarit kur në të vërtetë nuk ishin të tillë dhe që posedimin e kishin marrë nëpërmjet dëshmisë ose thjesht automatike. Në rastin unik krahasuar me periudhat e hershme të zhvillimit ligjor të trashëgimisë, kjo periudhë trajton

dhe rastet kur pjesë e padisë mund të ishin si të paditur dhe shteti ose ndonjë organizatë shtetërore.

Objekti për këtë padi, sipas dekretit, ishte i njëjtë me Kodet Civile paraardhëse të Dekretit, pra ishte njohja e cilësisë së trashëgimtarit.

E drejta për të ngritur një padi trashëgimi i takon përkatësisht atij trashëgimtarit ose atyre trashëgimtarëve të cilëve u është mohuar e drejta e të qenurit trashëgimtar. Kjo nuk është risia që ky Dekret ofron, por risia qëndron në disa elemente të padisë. Padia për kërkimin e trashëgimit mund të parashkruhet brenda 6 (gjashtë) viteve nga momenti i çeljes së trashëgimisë. Risi e këtij dekreti ishte rasti kur shteti ose një organizatë shtetërore ishte palë e paditur në këtë padi. Për raste të tilla paditësi nuk kishte të drejtën e parashkrimit të padisë. Krahas padisë për kërkimin e trashëgimit, ky dekret si mjet tjetër mbrojtës i të drejtës trashëgimore ka dhe:

- a. Padinë e pjestimit të trashëgimit dhe
- b. Padinë për deklarimin të pavlefshëm të dëshmisë së trashëgimisë.

Padia për deklarimin e pavlefshëm të dëshmisë së trashëgimisë ngrihet në favor të trashëgimtarit dhe për rastet kur trashëgimtarit dhe trashëgimia nuk i përgjigjet të vërtetës. Deklarimi i pavlefshëm i dëshmisë së trashëgimisë ishte një mjet mbrojtës por shihet si i panevojshëm pasi i gjithë qëllimi i gjykimit ishte njohja e cilësisë si trashëgimtar ndaj dhe kur gjykimi të jepej, dëshmia do të konsiderohej automatikisht e pavlefshme. Kjo dëshmi kishte fuqi deri në momentin që provohej nga gjykata.

Si rrjedhojë, ky mjet nuk është përfshirë në Kodin Civil aktual të implementuar në vitin 1994.

3.5 Padia për kërkimin e trashëgimit gjatë periudhës së Republikës Popullore Socialiste Shqiptare, 1982.

Në periudhën kur në Shqipëri ekzistonte periudha diktatoriale komuniste, Kodi Civil i aprovuar nuk kishte fuqinë që Kodet e mëparshme civile kishin apo dhe Kodi Civil i sotshëm ka. Marrëdhëniet juridiko-civile e pronësisë në atë kohë nuk kishte një bazë ku të mbështetej pasi në këtë periudhë prona private nuk ekzistonte dhe u fuqizua së tepërmi prona shtetërore e cila lidhej me faktorët ekonomikopolitike të kohës (Padia për kërkimin e trashëgimit dhe praktika gjyqësore në lidhje me të, 2022, p. 8). Në vitin 1982 trashëgimia përtej “goditjes” që pësoi për shkak të faktorëve politike dhe frymës që sillte ky faktor politik, pësoi dhe

goditje për shkak se tashmë nuk shihej më si një institut i veçantë por si një menyrë e fitimit të pasurisë.

Në të vetmen dispozitë që Kodi Civil e parashikonte trashëgiminë (Neni 101) (E Drejta e Trashëgimisë e R.P.S.SH, 1984, p. 126), legjislatori rregulloi mënyrën e fitimit të pronësisë me trashëgimi dhe në të njëjtën kohë rregulloi dhe specifikisht padinë për kërkimin e trashëgimit. Krahas mundësisë për të përdorur si mjet specifik për mbrojtjen e të drejtave trashëgimore, paditësit i ofrohej si mundësi prej legjislatorit dhe përdorimi i rregullave që rridhnin nga paditë e zakonshme (E Drejta e Trashëgimisë e R.P.S.SH, 1984). Teorikisht, padia për kërkimin e trashëgimit në periudhën diktatoriale të vëndit, është trajtuar sipas parimeve dhe nocionit bazë që përmban instituti i trashëgimisë në tërësi. Objekti i kësaj padie ishte i pandryshuar nga ai i dekretit të vitit 1954 dhe nga Kodi Civil i periudhës së Mbretërisë Shqiptare. Çdokush që dëshironte të ngrinte një padi për trashëgimin, objekt kryesor të saj duhet të kishte mohimin e të drejtës trashëgimore dhe mohimi i cilesisë si trashëgimtar i pasurisë trashëgimore. Nga kjo kërkesë që çdokush mund të bënte pranë gjykatës, kërkonte të bëhej njëkohësisht dhe njohja e trashëgimisë dhe dorëzimi i pasurisë trashëgimore që mbahej plotësisht apo pjesërisht nga i padituri që mund të ishte dhe një trashëgimtar tjetër. Që të konsiderohej si padi prej gjykatës duhej domosdoshmërisht që personi i paditur të ishte trashëgimtar por nuk mund të ngrihej ndaj atyre që mbanin pronësinë pa titull ose e mbanin në bazë të një titulli tjetër që ata pretendonin se e dispononin.

Ndryshe nga trajtimi i mëparshëm, i padituri mund të konsideronte veten trashëgimtar në dy forma: a) në mirëbesim dhe b) në keqbesim kur mbante trashëgiminë në bazë të një titulli të vlerësuar ose për rastin e dytë kur nuk kishte titull. Rëndësia e elementit të mirëbesimit dhe keqbesimit qëndronte vetëm tek fakti i kthimit të pasurisë së fituar nga posedimi i pasurisë (E Drejta e Trashëgimisë e R.P.S.SH, 1984).

Si shembull për këtë argument mund të përmendim rastet kur ndarja e pasurisë trashëgimore bëhet mes bashkëshorteve dhe fëmijëve dhe mund të ekzistojë rasti kur njëri prej bashkëshortëve trashëgimlënës ka një fëmijë jashtë martesor apo nga një marrëdhënie e mëparshme i cili ose e cila vihet në dijeni të ekzistencës së testamentit dhe kërkon t'i njihet cilësia si trashëgimtar.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të vitit 1970, pranoi gjithashtu dhe padinë për kërkimin e trashëgimisë ndaj të paditurit (trashëgimtarit ligjor pretendues) që mban pasurinë trashëgimore në bazë të dëshmisë së trashëgimisë ((Vendim Nr.123, date 09.03.1970, Drejtësia Popullore, Nr.3., 1979, pp. 63-64)

Padia për kërkimin e trashëgimit në Kodin Civil të miratuar gjatë Republikës Popullore Socialiste Shqiptare ka ngjashmëri dhe ndryshime me padinë e kërkimit të sendit të cilat janë tepër të rëndësishme për të filtruar kuptimin dhe thelbin e secilës padi. Ne baze të përkufizimeve që ky Kod ka pasur, dallimet që dalin janë:

1. Elementi i përbashkët i këtyre dy padive e cila vazhdon dhe në ditët e sotme është fakti që këto dy padi janë padi reale dhe synimin e tyre e kanë të mbrojnë një të drejtë absolute. Si e tillë, mund të ngrihen kundër çdo personi që mban sendin pa ndonjë bazë ligjore. *“Njohja e pronësisë së paditësit është kusht i domosdoshëm për miratimin e kërkimit të paditësit. Karakteri njohës i kësaj padie rezulton nga vetë natyra e saj. Ky karakter i përgjigjet padisë së njohjes (pozitive) që sipas nenit 113/b të Kodit Civil nuk i nënshtrohet parashkrimit. Padia e rivendikimit (kërkimit të sendit) është padi reale dhe me të mbrohet e drejta e pronësisë mbi sendet individualisht të përcaktuara, qofshin të paluajtshme ose të luajtshme”* (Vendim Unifikues Nr.5, 2011, p. 8). Siç shihet dhe nga argumentimi i dhënë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ky element është thelbësor për të dy paditë pasi tregon se është ndër elementet statike që këto padi kanë dhe që i kanë rezistuar kohës dhe pas ndryshimeve tranzitore politike.
2. Objekti i padisë në padinë për kërkimin e sendit ndryshon nga objekti i padisë për kërkimin e trashëgimit. Padia për kërkimin e sendit në Kodin Civil të vitit 1982, si objekt kishte kërkimin e sendeve të përcaktuara individualisht ashtu siç dhe Vendimi Unifikues i vitit 2011 konfirmon. Nga ana tjetër, padia për kërkimin e trashëgimisë sipas dispozitave të vitit 1982 ka për objekt pasurinë trashëgimore në tërësi dhe përfshin dhe sende të përcaktuara individualisht por dhe sende të përcaktuara në gjini.
3. Padia për kërkimin e trashëgimisë ngrihej si padi ku kërkohet cilësimi i trashëgimtarit dhe mjafton të provohej vetëm ky element me anë të dokumentit të dëshmisë së trashëgimisë ose me dokumentin testamentar. Nga ana tjetër në padinë për kërkimin e sendit paditësi duhej të provonte të drejtën e tij të pronësisë mbi sendin që kërkonte t’i dorëzohej.
4. Në padinë për kërkimin e trashëgimisë, praktika ka pranuar si palë paditëse vetë trashëgimtarin që i’u mohua kjo e drejtë, dhe palë e paditur është pranuar personi që mban pasurinë me cilësinë e trashëgimtarit. Ndërsa në padinë për kërkimin e sendit, pronësia nuk mbahej nga pala nën cilësinë e trashëgimtarit por nën cilësinë e pronarit ose me një emërtim tjetër (E Drejta e Trashëgimisë e R.P.S.SH, 1984).

Megjithatë, doktrinat dhe analizat e bëra në atë periudhë kohore për këtë pjesë të fitimit të pronësisë, citonin ekzistencën e mundësisë së ngjashmërisë dhe kjo ngjashmëri mund të ishte e pashmangshme si rrjedhojë dhe ardhja e pasojave ishte e pashmangshme. Në rastet kur i padituri nuk mohonte cilësinë e trashëgimitarit dhe nuk pretendonte që ishte trashëgimtar por pretendonte pronësinë mbi sendin si të marrë në një formë tjetër si psh. blerje apo dhurim, atëherë paditësi nuk mund të mbrohej me anë të padisë për trashëgimin por duhej të ngrinte një padi për kërkimin e sendit. Në këtë padi, paditësi duhet të pretendonte se pasuria ka qenë e trashëgimlënësit dhe i padituri ishte nëndorës i paligjshëm dhe meqënëse pronësia i kishte kaluar atij me trashëgim, kërkonte nëpërmjet padisë dorëzimin e sendeve.

Rastet të cilat autorët lejonin ngritjen e padisë për trashëgiminë ishin rastet kur trashëgimia pretendohet nga një trashëgimtar i vijës së parë siç mund të ishte fëmijë ilegjitim i trashëgimlënësit. Në këtë rast ky trashëgimtar kërkon njohjen e cilësisë si i tille dhe kthimin e pjesës takuese të pronësisë së tij trashëgimore (E Drejta e Trashëgimisë e R.P.S.SH, 1984). Padia për kërkimin e trashëgimit për këtë periudhë, edhe pse ishte e limituar në praktikë, në teori mund të ngrihej dhe ndaj personave të tretë që u kalonte kjo pasuri e cila specifikohet dhe sqarohet në paragrafin të dytë të nenit 101 të Kodit Civil të Republikës Popullore Socialiste Shqiptare (E Drejta e Trashëgimisë e R.P.S.SH, 1984). Këta persona sipas këtij Kodi nëse e mbanin atë pasuri si trashëgimtarë, duhej të kthenin sendin paditësit. Megjithatë, ky kod specifikonte dhe raste përjashtimore nga ku palët e treta mund të liroheshin nga barra e dhënies së sendit një personi tjetër. Kur kjo pasuri ishte e fituar me anë të një veprimi juridik me mirëbesim dhe me shpërblim (kur ishte menduar se kjo pronësi kishte kaluar prej pronarit). Në këtë rast, pronarët dëmshpërbleheshin sipas nëndorësisë (Kodi Civil R.P.S.SH., 1982).

Një ndryshim i rëndësishëm ndërmjet Kodit Civil të kësaj periudhe dhe Kodit Civil të Mbretërisë Shqiptare dhe Dekretit si dhe tek përcaktimet e bëra nga doktrina dhe jurisprudenca e periudhës së komunizimit qëndron tek fakti që nuk parashikohej parashkrimi dhe si rrjedhojë praktika e adaptoi mekanikisht për një periudhë 1(një) vit e gjysëm dhe 3 (tre) vjet. Këto rregullime juridiko-civile të trashëgimisë të Kodit Civil të vitit 1982 vazhdoi si rrugëtim deri në vitin 1994 ku dhe u adaptua Kodi Civil modern që ekziston dhe sot.

3.5.1 Historik i fillimit modern të trashëgimisë dhe padisë për trashëgiminë.

Shteti shqiptar, përpara hyrjes në fuqi të Kodit Civil aktual, miratoi disa ligje në mënyrë që të bëhej kompesimi i të drejtës së pronarëve të cilët nuk posedonin më pronësi gjatë periudhës së komunizmit. Mbas viteve 1990 me ndryshimin e sistemit politiko-ekonomik dhe me rikthimin në identitet të pronësisë private, një nga ligjet e para të miratuara ishte ligji Nr.7491 datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore Kushtetuese”.

Në vitin 1993, kuvendi miratoi një nga ligjet më të rëndësishme të asaj kohe, Ligjin Nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve”. Ky ligj kishte si qëllim kompesimin dhe rikthimin e pronësisë për të gjithë individët që në periudhën e komunizmit u ishte konfiskuar apo ishte shtetëzuar prona. Me daljen e këtij ligji, u bë e domosdoshme dhe ngritja e organeve të cilat vendosnin kthimin dhe kompesimin e këtyre pronave ndaj ish-pronarëve. Megjithatë, kjo procedurë ka shfaqur problematikat e saj. Gabimet dhe problematikat pas rikthimeve të këtyre pronave kanë sjellë ndër vite mangësira në gjykimet e këtyre çështjeve si dhe janë bërë shpesh objekt konflikti gjyqësor. Si rrjedhojë, kjo problematikë është pasuruar me një gamë të gjerë praktikash gjyqësore dhe vendime unifikuese të Gjykatës së Lartë e cila ka unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me probleme të ndryshme të kësaj fushe. Gjithashtu, vendime të Gjykatës Kushtetuese kanë shfuqizuar shumë dispozita të Ligjit 7698, pasi kontradiktonin dispozitat kushtetuese (Vendim Nr.4, , 1994).

3.6 Padia për kërkimin e trashëgimit.

Padia për kërkimin e trashëgimit është padia e cila ashtu që në periudhën e të Drejtës Romake, konsiderohet si mjet mbrojtës i një të drejte subjektive të paditësit. Kjo është pikërisht dhe arsyeja pse kjo padi kategorizohet si një padi reale, pasi në fokus ka mbrojtjen e të drejtës subjektive të individit (trashëgimtarit) paditës.

Padia për kërkimin e trashëgimit rregullohet në nenin 349 dhe 350 ku më qartë neni 349 shprehet: *“Trashëgimtari mund të kërkoj me padi nga kushdo që posedon tërësisht ose pjesërisht pasurinë trashëgimore, njohjen e tij si trashëgimtar dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore dhe të pasurisë së fituar me anë të saj, sipas rregullave mbi posedimin me mirëbesim dhe me keqbesim”* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2016, p. 67). Kjo dispozitë sëbashku me nenin 350, shpejtojnë në thelb se cila është domëthenia e padisë për

trashëgiminë dhe cilat palë janë të legjitimuar për të ngritur këtë padi si dhe palët me vulnerabël ndaj kësaj padie. Kjo padi ka tre elementë kryesore të cilat japin rëndësi për pranimin nga gjykata të kësaj padie specifike. Këto elemente janë: subjektet e padisë, objekti i padisë dhe shkaku ligjor. Subjektet ligjore janë, subjekti aktiv që është pala paditëse që pretendon që i është mohuar një e drejtë themelore si dhe pala paditëse kundrejt të cilës padia është ngritur. Objekti i padisë është rivendosja e një të drejte subjektive të paditësit e cila i është cënuar në mënyrë të padrejtë. Ndërsa shkaku ligjor i ngritjes së padisë konsiston në arsyen e kërimit gjyqësor e cila ndahet në dy momente: e drejta dhe gjendja e faktit kundrejt kësaj të drejte (Procedura Civile e R.P të Shqipërisë, 2017).

I pandryshuar është fakti që mund të paditen dhe palët e treta krahas trashëgimtarëve të cilët pretendojnë se janë të tillë dhe parimi i mirëbesimit për palët e treta të cilët kanë përfituar nga disponimi dhe posedimi i pasurisë trashëgimore. Sipas nenit 350, i cili shprehet *“Poseduesi me mirëbesim që ka tjetërsuar po në mirëbesim sende nga pasuria trashëgimore, është vetëm i detyruar që t’i kthejë trashëgimtarit paditës çmimin e sendit të shoqëruar me faturën përkatëse. Kur këto të fundit nuk janë shlyer, këtij i kalon e drejta për të kërkuar shlyerjen e tyre”* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2016, p. 67), pala paditëse në momentin që njihet si trashëgimtar, pala e paditur kur ka përfituar prej pasurisë deri në atë moment që është bërë njohja, duhet t’i japi çmimin shoqëruar me faturën por jo sendin në vetvete.

Edhe pse padia për kërkimin e trashëgimit është e limituar në vetëm 3 nene të Kodit Civil shqiptar, ajo çfarë është e qartë është që në këtë padi kemi një legjitimin aktiv dhe një legjitimim pasiv. Legjitimiteti aktiv shpreh qartë se është legjitimiteti që lidhet me paditësin si pretendues i trashëgimit dhe si pretendues i faktit që i është mohuar cilësia e trashëgimtarit. Pasuria e tij mund të mbahet pjesërisht ose plotësisht nga personat që janë trashëgimtar deri në momentin e ngritjes së padisë dhe që sërish mohojnë të drejtat subjektive të pronësisë që rrjedhin nga trashëgimia.

3.6.1 Legjitimimi aktiv.

Procedura gjyqësore nis me hapjen e këtij procesi nga paditësi nëpërmjet dorëzimit në gjykatën përkatëse të kërkesë padisë. Nëpërmjet atkit procedural të dorëzimit të kërkesë padisë, paditësi kërkon, rivendosjen e të drejtës së tij subjektive, të mohuar nga pala që paditet. Kjo palë thërritet në gjykim. Paditësi dhe i padituri konsiderohen palë të procesit

gjqësor, terminologji e cila shpejgohet nga Kodi i Procedurës Civile në nenin 90/1 të tij. Palë, do të quhet: *“Palë në një gjykim civil janë personat fizikë ose juridikë në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi”* (Procedura Civile e R.P të Shqipërisë, 2017, p. 20). Kjo dispozitë lejon krahas personave fizikë dhe personat juridik si persona të legjitimuar për të ngritur padinë. Deri më tani, praktikisht, ngritja e padive për kërkimin e trashëgimit është kryer kryesisht nga personat fizikë por ligji nuk ndalon personat juridikë për të bërë të njëjtën gjë. Padiësi si person fizikë, për ngritjen e pretendimit të cënimit të të drejtës së tij, duhet që të plotësojë disa kushte që ndahen: kryesisht në kushte të përgjithshme të padiësit që nevojiten për ngritjen e çdo lloj padie dhe kushte të posaçme që lidhen me karakteristikat e padiësit që nevojiten për ngritjen e kësaj padie të posaçme.

Kushtet e përgjithshme që konsiderohen nga gjykata, janë kushtet e përcaktuara në nenin 1 dhe 2 të Kodit Civil të cilat shprehen: *“Çdo person gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të pasur të drejta dhe detyrime civile brenda kufinjve të caktuar me ligj”* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2016, p. 6).

“Zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij. Femija kur lind i gjallë gëzon zotësi juridike që nga koha e zënies” (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2014, p. 9). Pra zotësia juridike për të vepruar është kusht i përgjithshëm thelbësor i nevojshëm për ngritjen e kësaj padie dhe çdo padie tjetër.

Krahas nenit 1 dhe 2 të Kodit Civil, neni 6 i këtij kodit dhe neni 33 i Kodit të Procedurës Civile përcaktojnë se kush janë kushtet që padiësi duhet të plotësojë për të qenë i legjitimuar për të ngritur një padi që lidhen me zotesinë për të vepruar. Individu gëzon zotësi dhe aftësi të plotë për të vepruar në momentin që mbush moshën 18 vjeçare dhe për rastin përjashtimor që është martesë në moshën 14 vjeçare. Si kusht për të drejtën e ngritjes së padisë, neni 33 i Kodit të Procedurës Civile cakton: *“Nuk mund të ngrihet padi nga një person që i mungon zotësia juridike për të vepruar”*, pra ndalon çdo individ që nuk përmbush kriteret e mësipërme që të ngrejë një padi legjitime në gjykatë. Kjo dispozitë vlen si për palën padiëse ashtu dhe për të paditurin gjithashtu dhe për palën e tretë të përfshirë në këtë proces. Ndërsa për personat juridik, momenti i fitimit të zotësisë juridike arrihet kur rregjistrohen në gjykatë, pra që nga momenti që bëhet rregjistrimi i tyre. Verifikimi i zotësisë juridike është detyrë e posaçme e gjykatës (Palët dhe legjitimiteti i pjesmarrësve në procesin civil, 2002, p. 16).

Në ato raste kur konstatimi i mungesës së aftësisë juridike të personit bëhet në kohën e paraqitjes së kërkesë-padisë në gjykatë, gjyqtari duhet të kthejë padinë tek padiësi dhe të

njoftojë këtë të fundit për plotësimin e të metave dhe të caktojë një afat për plotësimin e këtyre të metave sipas përcaktimeve të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile. Në rastet kur konstatimi bëhet gjatë gjykimit të çështjes, atëherë gjyqtari vendos për pezullimin e çështjes derisa në gjykim të paraqitet përfaqësuesi ligjor i legjitimuar për ta përfaqësuar. Kjo zgjidhje është gjerësisht e pranueshme nga praktika. Pranohet, pasi individit nuk i mohoet e drejta e përfaqesimit nga një përfaqësues ligjor por humbet të drejtën të paraqitet vetë si palë në procesin civil dhe i njihet kjo e drejtë kur në procesin civil përfaqësohet sipas rregullave (Palët dhe legjitimiteti i pjesmarrësve në procesin civil, 2002, p. 17). Kjo mundësi jepet dhe për personat juridik që kanë humbur zotësinë juridike për shkak se janë ç’rregjistruar nga regjistri tregtar, para ngritjes së padisë ose gjatë procesit gjyqësor.

Kushti i fundit që duhet të plotësohet për legjitimitimin e padisë është kushti i interesit që paditësi duhet të këtë për ngritjen e saj. Sipas nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, “*Padia mund të ngrihet:*

- a) *për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur;*
- b) *për vërtetimin e qënies ose mosqënies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte;*
- c) *për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasojë juridike për paditësin”* (Procedura Civile e R.P të Shqipërisë, 2017, p. 20).

Interesi i paditësit siç dhe nënkuptohet nga kjo dispozitë duhet të jetë i ligjshëm, personal, i lindur dhe aktual në mënyrë që të pranohet nga gjykata dhe gjyqtari (Procedura Civile (Cikel Leksionesh), 2002, p. 23). Paditësi vetëm për shkaqet e mësipërme mund të legjitimohet për të ngritur padinë dhe vetëm nëse interesi i ligjshëm është pasuror ose jopasuror. Përveç interesit që duhet të jetë domosdoshmërisht i ligjshëm, për këtë padi të posaçme, interesi duhet të jetë dhe personal e cila nënkupton që cënimi i të drejtës që i bëhet paditësit duhet të jetë subjektiv dhe ligjërisht nuk mund të perfaqësojë askush të drejtën e cënuar të paditësit përveç rasteve përjashtimore që vetë ligji ofron. Së fundmi, që padia të pranohet duhet që paditësi të ketë një interes të lindur së fundmi pra në momentin e ngritjes së padisë ky interes duhet të jetë ekzistues dhe aktual pasi në të kundërt gjykata nuk pranon kërkesë-padinë. Për rastet kur gjatë gjykimit kuptohet që padia nuk është e lidhur me një interes të lindur gjatë ngritjes së padisë, atëherë në aspektin ideal, gjykimi duhet të pushohet, fakt për të cilën është shprehur dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin Nr.230, datë 23.01.2003 (Vendim Nr.230, 2003).

3.7.1.1 Personat e ligjshëm për të ngritur padinë:

Për ngritjen e padisë, legjislatori kërkon plotësimin dhe të kushteve të posaçme që janë të lidhura ekzaktësisht me këtë padi. Kushti kryesor i posaçëm që duhet të plotësojë është që ai duhet të jetë trashëgimtar i pasurisë objekt kërkimi dhe dy format e pranueshme dhe ekzistuese të trashëgimtarëve janë: trashëgimtar ligjorë dhe trashëgimtar testamentar.

Trashëgimtarët ligjorë sipas nenit 360 të Kodit Civil shqiptar janë: *“Trashëgimtarët ligjorë janë: fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti. Këta thirren në trashëgimi sipas rradhës së caktuar në këtë Kod”* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2016, p. 69). Kjo renditje përcakton prioritetet në trashëgiminë ligjore duke vendosur në një rëndësi të lartë fëmijët e trashëgimlënësit. Në vijim kategoritë më të hasura në paditë për kërkimin e trashëgimit.

A. Fëmijët e trashëgimlënësit:

Fëmijët e trashëgimlënësit ashtu siç dhe dispozita parashikon, janë të rradhës së parë dhe si rrjedhojë trashëgojnë të dy në mënyrë të barabartë. Fëmijët trashëgojnë nga të dy prindërit por rregullat nuk janë njësoj për çdo kategori “fëmijë”. Tek fëmijët trashëgues përfshihen të gjithë fëmijët që janë të njohur qoftë brenda apo jashtë martese, fakt i cili mbrohet dhe nga neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i cili shprehet *“Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa”*. Tek kategoria e fëmijëve që nuk përfshihen në trashëgiminë ligjore janë ato fëmijë që pretendojnë cilësinë e trashëgimtarit kur trashëgimlënësi është njerku ose njerka ose kur këta fëmijë janë kujdesur për trashëgimlënësin apo e kanë ushqyer. Për sa këta individë nuk janë të birësuar (Bicoku, p. 69), prej njerkut/njerkës dhe për sa nuk janë të paaftë për punë, legjislatori është shumë i qartë në përfshirjen e tyre në trashëgimi. Sërisht një vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka arsyetuar: *“Kërkuesja nuk përfshihet në asnjë prej kategorive të personave që ligji i njeh si trashëgimtarë ligjorë (bashkëshort, fëmijë, prindër, person i paaftë në ngarkim, vëlla, motër, gjysh ose gjyshe). Ajo personin trashëgimlënës e ka pasur njerkën e bashkëshortit...”* *“..Fakti që pretenduesja, për rreth 15 vjet e ka mbajtur me ushqim dhe*

është kujdesur për trashëgimlënësen nuk e bën atë trashëgimtare ligjore” (Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, 1971-1973, pp. 296-297).

B. Fëmijët e fëmijëve:

Fëmijët e fëmijëve të trashëgimlënësit (nipërit apo mbesat), janë pjesë e trashëgimit në mënyrë direkte, pra në rradhë të parë njësoj si prindërit e tyre por me anë të zëvendësimit duke zënë vendin e prindërve të tyre. Rastet kur ndodh zëvendësimi i cakton neni 361 i Kodit Civil:

“ Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, është bërë i padenjë për të trashëguar, ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është i përjashtuar nga trashëgimi, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij dhe kur për shkaqet e sipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë, vijnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim ” (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2016, p. 72).

Dispozita shpejgon se secili nga fëmijët e fëmijëve marrin pjesë në procesin e trashëgimit në mënyrë të barabartë dhe për rastet kur as kjo kategori nuk trashëgon dot në mënyrë direkte, atëherë fëmijët e tyre marrin pjesë gjithashtu me zëvendësim dhe kjo është e pakufizuar. Fëmijët nën moshën 18 vjeç si dhe fëmijët e fëmijëve dhe të paslindurit e tyre pa kufizim kur trashëgojnë me zëvendësim, kanë të drejtën e rezervës ligjore, ashtu si dhe personat të cilët janë të paaftë për punë.

C. Bashkëshorti pasjetues:

Me këtë terminologji kuptohet “burri” apo “gruaja” të cilët kanë krijuar një lidhje martesore të rregullt sipas kufizimeve ligjore. Bashkëshorti thirret në rradhë të parë sëbashku me fëmijët e trashëgimlënësit dhe të gjithë trashëgojnë pjesë në mënyrë të barabartë. Termi për të dy palët është i përdorshëm dhe nga ligji por nuk bën dallime, gjë që nënkupton se të dyja palët mund të trashëgojnë nga njeri-tjetri në pjesë të barabartë me fëmijët e tyre. Në lidhjen bashkëshortore mund të trashëgojnë vetëm ato që kanë lidhur një martesë të rregullt sipas ligjit pasi personat që kanë një lidhje bashkëjetese pa një status martesor, nuk trashëgojnë.

Nëse flitet për legjitimitetin pasiv, legjislatori analizon në mënyrë më të detajuar, e cila është pasuruar dhe me anë të praktikave gjyqësore. Si rrjedhojë, legjitimiteti pasiv shpejgohet si vijon.

3.7.2. Legjitimiteti pasiv.

Legjitimiteti pasiv është element kyç i padisë për kërkimin e trashëgimit i cili trajtohet dhe në shumë praktika gjyqësore të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Doktrina kërkon që personat që mund të paditen ose që janë të paditur janë:

- a. Çdo person që posedon pasurinë trashëgimore duke konsideruar veten si trashëgimtar;
- b. Personi që mban si trashëgimtar pasurinë trashëgimore ku pjesë e kësaj kategorie mund të jetë dhe shteti (Shkolla e Magjistraturës, 2010).

Risia e këtyre ndryshimeve të ardhura në Kodin Civil të vitit 1994 lidhet pikërisht me përcaktimin e kategorisë së personave që mund të paditen nga trashëgimtarët pretendues. Pavarësisht se legjislatori është përpjekur të qartësojë këtë element, gjatë periudhës së zbatimit të këtyre dispozitave, ka pasur dhe hapsirë për keqinterpretime. Krahas mungesës së interpretimit korrekt nga personat, keqinterpretimet janë lidhur kryesisht dhe me momentin se kujt i bie legjitimiteti. Momenti i rënies së legjitimitetit ka shërbyer si baze për përcaktimin e llojit të padisë, pasojave juridike që rrjedhin dhe pasojave juridike që kishin të bënin me parashkrimin e kësaj padie.

Praktika gjyqësore dhe specifikisht vendimi Nr. 36 të vitit 1956 i Gjykatës së Lartë (Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, Nr.36, , 1956), ka konsideruar parashkrimin e kësaj padie si të konkluduar nëse do të ishte plotësuar afati kohor prej 3 (tre) vitesh dhe kjo lidhej me Nenin 19/3 të Dekretit Nr.1892 “Mbi trashëgiminë” e cila shprehej: *“Padia për kërkimin e trashëgimit parashkruhet me kalimin e tre vjeteve nga koha e çeljes së trashëgimisë. Kur trashëgimtari është shteti, padia nuk parashkruhet”*. Kjo nënkupton se kjo dispozitë mund të zbatohet vetëm për legjitimitetin pasiv dhe kryesisht vetëm për ato persona që posedonin trashëgiminë nën statusin e trashëgimtarit dhe jo ndaj çdo personi që pretendonte se ishte posedues. Neni 19 i këtij dekreti ka qenë si pikë reference për kategorinë e personave që mund të paditeshin dhe për legjitimitetin e parashkrimit. Sipas këtij neni në pikën 1 dhe 2 të tij që thuhet: *“Trashëgimtari ka të drejtë të ngrejë padi kundër personit që mban pasurinë si trashëgimtar për t’i u njohur e drejta trashëgimore dhe për t’iu dorëzuar pasuria*

trashëgimore ose pasuria e fituar me anë të kësaj sipas rregullave mbi poseduesin me mirëbesim dhe keqbesim”, dhe “Padia mund të ngrihet dhe kundër personit që mban pasurinë si trashëgimtar në bazë të një dëshmie trashëgimie (Neni 17), edhe kur ky është shteti. Personi që ka fituar me mirëbesim ndonjë send të pasurisë trashëgimore nga një trashëgimtar i tillë nuk është i detyruar ta kthejë këtë send” (Dekret Nr.1892 "Mbi Trashëgiminë", 1954, p. 212), lejohej ligjërisht ngritja e padisë për sa kohë që nuk kishte kaluar afati ligjor sipas ligjeve të caktuara të kohës. Ndryshe vlen për nenin 349 i cili është neni ekuivalent i nenit 19 të dekretit të sipër përmendur. Në nenin 349, legjislatori përcakton se në mënyrë që gjykata të pranojë padinë duhet që i padituri të jetë posedues i pasurisë me anë të një titulli dhe ky titull duhet të jetë dëshmi trashëgimie. Nëse i padituri posedonte sendin pa një titull të tillë, gjykata nuk pranonte padinë e ngritur nga paditësi. Në raport procedural, paditësi duhej të provonte statusin e tij si trashëgimtar duke e paraqitur përpara gjykatës së bashku me të gjitha dokumentacionet e tjera të nevojshme për ngritjen e kësaj padie. Megjithatë, pyetja që është ngritur përherë qendron tek fakti që ky faktor ngre ndonjëherë problematika por a mundet të provohet dhe në një moment të dytë cilësia e trashëgimtarit nga ana e paditësit? Bazuar në praktikën gjyqësore, cilësia si trashëgimtar mund të provohej dhe gjatë gjykimit në themel pa pasur nevojë për të pasur një dëshmi trashëgimie paraprake për t’ju dorëzuar gjykatës. Këtë dokumentacion gjykata mund ta zëvendësojë me një vendim të ndërmjetëm që rregullonte cilësinë e trashëgimtarit. Praktikrat e mëparshme kërkonin nga trashëgimtari (pretenduesi si i tillë) që krahas çdo dokumentacioni që gjykata kërkonte, të dorëzohej dhe dëshmia e trashëgimisë e lëshuar sipas Nenit 348 të Kodit Civil.

Vetë akti i dëshmisë së trashëgimisë kërkohet detyrimisht vetëm për rastet si vijon:

1. Testament (nëse ka);
2. Nëse trashëgimtar është shteti;
3. Jane marrë depozitat në bankë;
4. Kur objekti i pasurisë së trashëgimit është pasuri e luajtshme, e paluajtshme që kërkohet rregjistrimi në rregjistrin publik në mënyrë të detyrueshme dhe do të duhej kryerja e veprimeve të caktuara (Udhëzim i Pleniumit të Gjykatës së Lartë Nr.6, 1956);
5. Objekti është një e drejtë kredie ose/apo një e drejtë që rrjedh nga kuotat apo aksionet e një shoqërie tregtare.

Edhe pse për rastet e sipërpërmendura akti është detyrimisht i kërkueshëm, ekziston rasti kur mbrojtja që duhet të bëjë trashëgimtari është urgjente dhe dëshiron të jetë efikase dhe pritja për daljen fizike të këtij dokumenti merr një kohë më të madhe sesa është në gjendje të presi paditësi. Megjithatë, edhe nëse këto dokumentacione paraqesin një aspekt detyrimor që paditësi duhet të ketë për ngritjen e padisë, edhe nëse paraqitja e dëshmisë së trashëgimisë bëhet gjatë gjykimit në themel, praktika gjyqësore dhe doktrinale nuk e ka kundërshtuar, madje e ka përqafuar dhe e ka lënë në vazhdimësi.

Ashtu siç dhe më sipër u citua, gjatë gjykimit në themel mund të jetë i mjaftueshëm dokumentacioni/ vendimi i ndërmjetshëm i gjykatës. Është pranuar se mund të procedohet dhe pa një vendim të tillë dhe mund të procedojë me shqyrtimin e çështjes duke shqyrtuar kërkimin tjetër, atë të dorëzimit të pasurisë trashëgimore. Ajo që do i nevojitej paditësit në raste të tilla, do ishin provat, në mënyrë që të provonte në një formë tjetër cilësinë e trashëgimtarit (Udhëzim Nr. 6, 1956). Provat sipas dekretit të kohës, ishin dokumentacione provuese si, aktet e vdekjes së trashëgimlënësit të cilat ishin dokumenta zyrtare që provonin lidhjen e gjinisë midis trashëgimtarit dhe trashëgimlënësit, testamenti (nëse kishte), për personat e paaftë për punë, prova dhe dokumenta që provojnë paaftesinë e tyre sipas dekretit, dhe nëse shihej si e nevojshme, prova me dëshmitare.

Por a mund të quhen që të gjitha rastet e ngjashme të konsiderueshme si padi të posaçme për trashëgimin?

Për këtë pyetje, legjislatori përcakton qartë që nuk mund të gjitha rastet të klasifikohen si të ngritshme për padinë e posaçme. Kur trashëgimtari nuk hyn në mënyrë të menjëhershme pas vdekjes së trashëgimlënësit në posedim faktik të pasurisë trashëgimore, gjykata nuk mund ta pranojë si një padi të posaçme por do të klasifikohet si një padi për kërkimin e sendit (Kodi Civil, 1981), (Dekret Nr.1892 "Mbi Trashëgiminë", 1954).

3.7.3. Praktika lidhur me nenin 349 dhe vijues për padinë për trashëgimin.

Edhe pse neni 349 bën përkufizimin e asaj çfarë konsiderohet padi për trashëgimin dhe cilat janë kriteret e ngritjes së kësaj padie, fatkeqësisht gjatë viteve të zbatimit të këtij neni, ka pasur keqinterpretime nga gjykata. Doktrina ngre një pyetje e cila qëndron pikërisht te mundësia e ekzistencës së ngritjes së një padie midis trashëgimtarëve. Kjo lidhet me pasojën juridike që saktësimi i një momenti të tillë sjell dhe kjo pasojë pasqyrohet tek

mosparashkrimi i kësaj padie të posaçme sipas nenit 351 të Kodit Civil. Ky nen thotë: “*Padia për kërkimin e trashëgimit nuk parashkruhet, përveç efekteve të parashkrimit fitues për sende të veçuara*” (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2016, p. 71). E për t’u rikthyer tek neni 349, ky argument lidhet direkt me faktin që në këtë dispozitë nuk bëhet diskriminim lidhur me personat që përfshihen në padi. Madje, shkon deri në atë pikë sa të përfshijë të gjithë (Vendimi Nr.6 i Kolegjeve të Bashkuara, 2007), poseduesit e lirë qoftë të një pjese të pasurisë apo të të gjithës, dhe si rrjedhojë kjo padi mund të ngrihet dhe mes trashëgimtarëve me njëri tjetrin kur kjo e drejtë themeltare u mohohet.

Sërisht në praktikën e gjerë gjyqësore, kërkohet që personi që pretendon se ka mbajtur pasurinë, të paraqesë një dokumentacion të çfarëdoshëm që provon cilësinë e trashëgimitarit. Gjykata mund të pranojë këtë dokumentacion por doktrina e konsideron si kontradiktore pasi konfronton nenin 350 të Kodit Civil e cila lidhet me pasojën e ardhur nga fitimi në mirëbesim i një sendi pasurie trashëgimore nga personi që deri në atë moment e ka mbajtur me anë të dëshmisë.

Neni 349, detyron të paditurin për kthimin e pasurisë së poseduar nga i padituri dhe sëbashku me sendin dhe çdo gjë që ka fituar nga shfrytëzimi i saj, brenda rregullave të mirëbesimit dhe keqbesimit. Për aspektin e keqbesimit, legjislacioni konsideron çdo person që nuk ka një titull dhe është në dijeni që nuk është trashëgimtar por vazhdon të posedojë sendin.

3.7.4 Objekti i padisë.

Objekti i padisë përbën krahas palëve, elementin kyç për ngritjen dhe njohjen e padisë. Nëse në ngritjen e një padie do jetë një objekt i gabuar, atëherë automatikisht do të nënkuptonte se do të kishte mungesë të interesit të paditësit për vazhdimin e gjykimit, e cila do të çonte drejtë mungesës së një gjykimi dhe vazhdimësie të saj. Siç dhe është përmendur me sipër, objekti i kësaj padie është kërkesa e paditësit për të rivendosur një të drejtë subjektive të cënuar apo mohuar nga paditësi ose paditësit. Objekti i padisë për kërkimin e trashëgimit, përbëhet nga tre kërkesa kryesore, njohja e paditësit si trashëgimtar i pasurisë trashëgimore, dorëzimi i pasurisë trashëgimore dhe dorëzimi i pasurisë së fituar (Palët dhe legjitimiteti i pjesmarrësve në procesin civil, 2002, p. 39). Sipas dispozitave të Kodit Civil, paditësit kanë të drejtën që në këtë padi të kërkojnë të tre elementet e sipërpervendur (Vendim Nr.19 i Kolegjeve të Bashkuara, 2002). Ligjërisht, këto kërkime nuk pretendohen të shkëputura por

të gjitha bashkë në një padi të vetme (Neni 19 L.T, Padia per Kerkimin e Trashëgimise, 1958, p. 37). Padiësi nuk mund të kërkojë vetëm njohjen e tij si trashëgimtar (cilësinë si i tillë) pasi kjo është lehtësisht e verifikueshme me anë të dëshmisë së trashëgimisë ndaj si rrjedhojë është e ndërlidhur me kërkesën për dorëzimin e pasurisë trashëgimore dhe dorëzimit të pasurisë së fituar prej saj.

Praktikisht këto padi ngrihen dhe të pavaruara nga njëra tjetra por secila me specifikimet e saj. Ka disa raste të cilat padië janë pretenduar se mund të ngrihen veçmasi siç janë:

Rasti A): Padiësi ka kërkuar vetëm pjesën e detyrimit të dorëzimit të pasurisë trashëgimore që i takon atij nga trashëgimlënësi duke plotësuar kështu kërkesën e dytë nga tre kërkesat që mund të ngrihen si objekt gjykimi. Në këtë rast kemi vetëm këtë kërkesë pa kërkesën për njohjen e cilësisë si trashëgimtar (Vendim Nr. 6238, Gjykata e Rrethit Tiranë, 1996).

Rasti B): Padiësi ka kërkuar vetëm detyrimin që pala e paditur të njohë atë si trashëgimtar të trashëgimlënësit në bazë të neneve të Kodit Civil (Vendim Nr. 2844, Gjykata e Rrethit Tiranë, 1996).

Rasti C): Padiësi ka ngritur padinë për kërkesën e trashëgimit duke kërkuar pasurinë trashëgimore pa kërkuar më parë njohjen si trashëgimtar (Vendim Nr.5167, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, 2004).

Rasti D): Padiësi ka kërkuar njohjen e tij si trashëgimtar të trashëgimlënësit sëbashku me detyrimin që trashëgimtarët e tjerë kanë për dorëzimin e pasurisë trashëgimore (Vendim Nr.6054, Gjykata e Rrethit Tiranë, 1996).

Rasti E): Raste nga praktika kanë pasqyruar momente kur padiësi ka kërkuar njohjen e tij si trashëgimtar sëbashku me detyrimin që i padituri ka për t'i kthyer të ardhurat e fituara në keqbesim nga përdorimi i pasurisë trashëgimore (Vendim Nr.1466, Gjykata e Rrethit Tiranë, 1998).

Nga keto raste, mund të themi se padiësi s'mund të pretendojë këto kërkesa pa legjitimuar plotësisht statusin e tij si trashëgimtar e cila bëhet vetëm me anë të disponimit të dëshmisë së trashëgimisë si një element që siç është analizuar gjatë këtij shkrimi, është tepër i rëndësishëm. Në padinë për kerkimin e trashëgimisë, padiësi nuk mund të kërkojë si objekt të padisë, njohjen e cilësisë si trashëgimtar pa kërkuar dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore.

Më tej, praktika gjithashtu ka shfaqur raste kur pasuria është e pandarë dhe padiësit i mohoet cilësia si bashkëtrashëgimtar, atëherë padiësi ngre padi për dorëzimin e vetëm një pjesë të pasurisë, përkatësisht pjesës që i takon e cila mund të jetë p.sh $\frac{1}{4}$ ose $\frac{1}{2}$ e pasurisë.

3.7.5. Problematikat në praktikën gjyqësore lidhur me përcaktimin e objektit për padinë për kërkimin e trashëgimit.

Problematikat në praktikën gjyqësore lidhur me këtë padi vijnë si rezultat i objektit të gabuar të kërkuar nga ana e paditësit. Në shumë raste paditësi ka pasur si qëllim ngritjen e padisë për kërkimin e trashëgimit duke vendosur një bazë ligjore korrekte, por në objekt nuk ka shprehur kërkimet që parashikon neni 349 për padinë për trashëgimin por ka kërkuar ndryshimin e dëshmisë së trashëgimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit ndaj të paditurve (Vendim Nr.697, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, 2006). Në raste të tjera, në vend të kërkesës për padinë për kërkimin e trashëgimit kundër të paditurve që pretendojnë se janë trashëgimtar në bazë të dokumentit (dëshmi trashëgimie), paditësi ka kërkuar deklarimin e pavlefshëm të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë që ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë në favor të të paditurve. Me të drejtë, në këtë rast gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë për shkaqe të pambështura në ligj. Vendimi nr.4463, datë 28.05.1996, është shprehur për këtë argumentim si më poshtë: *“Paditësi nuk duhej të ngrinte këtë padi me këtë objekt. Vendimet për vërtetimin e fakteve juridike nuk mund të goditen me atë objekt, por me padi themeli siç mund të jetë padia e pjestimit, e njohjes së pronësisë ose e cënimit në pronësi etj”* (Vendimi nr.4463, Gjykatës së Rrethit Tiranë, 1996).

Një problematikë tjetër që lind lidhur me këtë padi, është pikërisht dhe padia kur për objekt ka njohjen si bashkëpronar dhe jo si bashkëtrashëgimtar. Në aspektin leksik këto dy fjalë kanë një pikë të përbashkët lidhjeje e cila ka të bëjë me bashkëtrashëgimtarët e pronës së trashëguar. Ata konsiderohen njëkohësisht dhe bashkëpronarë në momentin e njohjes së tyre si të tillë ndaj dhe kjo shprehi nuk mund të konsiderohet si shprehi apo kërkesë e gabuar. Me çeljen e trashëgimisë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit pronësia kalon tek trashëgimtarët të cilët në linja të gjëra marrin statusin e bashkëpronarëve.

Si pefundim, njohjen si bashkëpronar paditësi kuptohet se e pretendon në cilësinë e bashkëtrashëgimtarit.

Në Nenin 6 i Kodit të Procedurës Civile thuhet: *“Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithshka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”* (Procedura Civile e

R.P të Shqipërisë, 2017, p. 15). Edhe pse dispozita shprehet në këtë formë, ka raste kur gjykata nuk e ndjek këtë parim por ndjek praktiken e saj. Kur paditësi ka kërkuar vetëm njohjen si bashkëpronar të pasurisë trashëgimore, gjykata ka vendosur dhe dorëzimin e asaj pjese takuese në pasurinë trashëgimore, duke vendosur qartazi përtej objektit të padisë së ngritur (Vendim nr.4335, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, 2004).

Shpesh herë padia për kërkimin e trashëgimit është përdorur në mënyrë të gabuar nga pala paditëse por shqetësimi më i madh është përdorimi dhe interpretimi i gabuar i kësaj padie nga gjykata. Një analizë të tillë e ka bërë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.6, datë 24.01.2007. Në këtë vendim Gjykata ka shprehur interpretimin më të gjerë të padisë për kërkimin e trashëgimit dhe rolin që ligji për kompesimin e pronave luan në këtë padi. Trashëgimia në thelbin e saj ka një send që mund të jetë pronësi, por nuk është e domosdoshme që çdo rast të trajtohet në këtë formë. Në këtë vendim, paditësja dhe i padituri kishin marrëdhënie motër-vella, dhe i padituri kishte marrë në pronësi një truall të dhënë nga agjensia e kompesimit të pronave e cila sipas analizës së Kolegjit Civil, i takonte trashëgimlënësit të tyre dhe që ndarjen pasurore nuk duhej ta bënte kjo agjensi. I padituri me fitimin e kësaj pronësie, kishte dhuruar truallin një familjari dhe më tej personi kishte lidhur një kontratë sipërmarrjeje me një shoqëri.

Nga rrethanat e mësipërme të çështjes, Gjykata e Lartë parashtroi se kjo padi është trajtuar në mënyrë të gabuar sepse nuk duhet parë si një padi për pronësinë por si një padi ku cilësia e trashëgimtarit është mohuar nga bashkëtrashëgimtari tjetër. Një trashëgimtar i vetëm ka marrë të gjithë sendin duke mos përfshirë trashëgimtarët e tjerë ligjorë të cilët me çeljen e trashëgimisë nuk përfituan asgjë. Kjo çështje ishte pikërisht pikëkthimi për praktikën gjyqësore.

Unifikimi i praktikës gjyqësore që ka ndihmuar doktrinat të zgjerojnë analizën e tyre, lidhet me përcaktimin e elementit pasiv dhe legjitimitetin e tyre.

Me këto praktika, gjykata përpiqet të japi qasjen ligjore lidhur me pengesat që hasen lidhur me padinë për kërkimin e trashëgimit. Gjykata e Lartë bën evident faktin se gjykatat e rretheve hasin vështirësi në njohjen dhe përcaktimin e momentit kur një padi është një padi kërkimi për trashëgimin dhe kur një padi është padi për rivendikimin apo kërkimin e sendit.

Për rastet kur paditësi pretendon pasurinë trashëgimore në bazë të një testamenti absolutisht të pavlefshëm, paditësi duhet të ngrejë padinë për kërkimin e trashëgimit (Padia për kërkimin e trashëgimit dhe praktika gjyqësore në lidhje me të,, 2022).

3.7.6 Gjykatat kompetente për gjykimin e padisë për kërkimin e trashëgimit.

Kodi i Procedurës Civile shprehet se padia për kërkimin e trashëgimit ngrihet në gjykatën e rrethit ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin e fundit përpara vdekjes së tij. Por ka raste që vendbanimi i trashëgimlënësit për arsye objektive mund të mos dihet ose mund të jetë jashtë Shqipërisë. Ekzistojnë dhe raste kur pasuria trashëgimore nuk ndodhet në vendin tonë dhe si rrjedhojë për raste të tilla praktika ka përcaktime të veçanta.

Për rastin kur vendbanimi nuk dihet, legjislacioni përcakton se gjykata kompetente do jetë ajo gjykatë ku pasuria ndodhet ose ku ndodhet pjesa më e madhe e saj. Ky shembull vlen dhe për rastet kur trashëgimlënësi është shtetas shqiptar dhe përpara vdekjes së tij banesa e fundit e tij nuk ka qenë në Shqipëri. Megjithatë, përpara se të procedohet me vendin ku ndodhet pasuria, Kodi i Procedurës Civile kërkon që fillimisht të zgjidhet vendi ku për herë të fundit ka banuar trashëgimlënësi në Republikën e Shqipërisë dhe kur të dyja këto opsione shterojnë dhe pasi banesa e fundit zbulohet që është jashtë vendit, atëherë gjykata kompetente është gjykata e kryeqytetit.

Padia për kërkimin e trashëgimit ka si veçori faktin që palët mund ta vendosin me marrëveshje me shkrim kompetencën e gjykatës. Pra, mund ta ndryshojnë me anë të një dokumenti të shkruar dhe të nënshkruar nga të dyja palët.

Kodi i Procedurës Civile rregullon marrëdhënien trashëgimore dhe mjetet e tyre mbrojtëse dhe për këtë arsye lind pyetja, a do vlejnjë të njëjtat dispozita dhe për shtetasit e huaj që vendosin të lenë një pasuri trashëgimore në vendin tonë ose një shtetas shqiptar? Legjislacionet e veçanta të cilat hartohen në funksion të rasteve të tilla i japin zgjidhje këtyre dilemave.

Ligji që rregullon marrëdhëniet në ditët e sotme, qoftë trashëgimore ose jo të shtetasve të huaj në raport me shtetasit dhe shtetin shqiptar, është ligji “Për të Drejtën Private” e cila specifikon në mënyrë më të theksuar marrëdhënien testamentare.

4. ASPEKTE KRAHASIMORE TË VENDIT TONË ME VENDET E RAJONIT

4.1 Padia për kërkimin e trashëgimit sipas legjislacionit Italian

Legjislacioni italian i trashëgimisë është një institut shumë i veçantë dhe gjithëpërfshirës. E drejta italiane e trashëgimisë për trashëgiminë testamentare bazohet në testamentin e fundit që trashëgimlënësi ka lënë, pavarësisht kjo nga natyra e luajtshme apo e paluajtshme që pasuria trashëgimore mund të ketë. Kjo metodë i bën trashëgimtarët të trashëgojnë bashkarisht dhe në mënyrë të barabartë dhe pasurinë por dhe detyrimet. Përrjashtim janë rastet kur testamenti parashikon ndryshe. Në ligjin italian, është pikërisht përmbatja e testamentit elementi dallues ndërmjet përfitimeve të trashëgimtarëve ligjore dhe atyre testamentar.

Procesi i trashëgimisë, njësoj si në të drejtën civile shqiptare nis në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit dhe perfundimin formal e ka në momentin e kalimit përfundimtar të pasurisë apo pasurive. Në teresi të procedurës së çeljes së trashëgimisë, Italia ka të njejtën qasje me shtetin shqiptar. Trashëgimtarët bëjnë çeljen përpara një Noteri i cili si teknik ka funksionin e konstatimit të vlefshmërisë së testamentit dhe rrespektimin e dispozitave të detyrueshme dhe politikave publike të caktuara që shteti italian ka. Funksion i Noterit është gjithashtu dhe përcaktimi nëse trashëgimtari ose trashëgimtarët janë të aftë për të trashëguar dhe a janë të aftë për t'u bërë trashëgimtar (Italian Inheritance Law, A Brief Guide for Foreigners, 2022, pp. 1-4). Në përfundim të interpretimit të testamentit të lënë, Noteri bën ndarjen e pasurisë në pjesë të barabarta sipas trashëgimtarëve të përcaktuar në testament. E veçanta e ligjit italian qëndron gjithashtu dhe tek fakti që krahas Noterit, të drejtën për të kryer formalitetet e përcaktuara me ligj, i kanë dhe autoritetet publike.

Për të pasur sukses nga pikëpamja procedurale, trashëgimtari ose trashëgimtarët duhet të provojnë të drejtën ose statusin e tyre si të tillë. Por cila është mënyra që trashëgimtarët italiane të provojnë cilësinë e tyre si trashëgimtar? Ndryshe nga procedura në Shqipëri e cila kërkon thjesht marrjen e kopjes fizike të deshmisë së trashëgimisë, shteti italian parashikon një rrugëtim pak më të gjatë. Cilësia e trashëgimtarit provohet me anë të një akti i cili ka si funksion specifikimin e personave që janë të legjitimuar të njoftohen për të tërhequr pasurinë objekt trashëgimie por gjithashtu dhe të drejtat që lidhen me të. Në rast të mungesës së këtij akti, trashëgimtari duhet t'i paraqesi gjykatës një deklaratë të betuar në prani të noterit dhe të dy dëshmitarëve të tjerë ose përpara autoritetit publik kompetent. Testamenti i bërë në formën e aktit publik, publikohet automatikisht në momentin e hapjes së trashëgimisë por noteri duhet që të bëjë rregjistrimin e kopjes pranë sekretarisë së gjykatës dhe më tej të njoftojë trashëgimtarët.

Krahas këtij trajtimi, praktikë italiane fokusohet shumë dhe në goditjen e trashëgimive testamentare dhe rastet kur mund të ngrihet si padi. Si një akt i revokueshëm, testamenti është kryesisht mjete kryesor për disponimin e pasurisë. Një nga rastet më të përhapura të kundërshtimit, është pikërisht rasti kur trashëgimtari është paaftë për të lënë një trashëgimi. Në këtë rast testamenti mund të kundërshtohet nga kushdo që ka një interes të caktuar në pasurinë përkatëse e cila nënkupton jo vetëm trashëgimtari i caktuar por dhe personat të cilët janë përjashtuar nga trashëgimia. Kjo padi skadon brenda pesë vitesh nga momenti që është bërë ekzekutimi i dispozitave kalimtare (How to challenge an Italian Will, 2022, pp. 1-3).

Nëse trashëgimlënësi përpara vdekjes së tij në testamentin e hartuar e ndan pasurinë në mënyrë që nuk plotëson standartet e vendosura nga ligji, trashëgimtarët kanë të drejtë të kërkojnë kompesimin për çdo humbje që u është bërë, të cilën mund t'a marrin ose nga pasuria trashëgimore ose nga trashëgimtarët e tjerë që kanë marrë më shumë pjesë nga rezerva ligjore italiane. Këtë kërkesë trashëgimtarët të cilëve u është privuar e drejta e trashëgimisë, e paraqesin përpara gjykatës duke kërkuar dhe rikuperimin e dëmit të shkaktuar (My lawyer in Italy, Inheritance law, 2023).

4.1.2. Padia për kërkimin e trashëgimit italian krahasuar me atë shqiptar.

Nga përmbajtja e dy legjislacioneve është e qartë që Kodi Civil shqiptar ka marrë si pikë reference Kodin Civil italian dhe dispozitat e tij. Ashtu si neni 349 i K.C shqiptar, edhe ai italian e parashikon padinë për kërkimin e trashëgimit si një mjet për mbrojtjen e të drejtës

trashëgimore të trashëgimtarëve. Ky institut rregullohet nga nenet 533-535 të Kodit Civil italian.

“Trashëgimtari mund të kërkojë njohjen e cilësisë së tij si trashëgimtar kundër kujtdo që posedon të gjithë ose një pjesë të pasurisë trashëgimore, me ose pa titull, me qëllim që të përfitojë kthimin e pasurisë trashëgimore” (Neni 533, Volumi i II, Kapitulli IX, Kodi Civil Italian, 1946). Nga kjo dispozitë interpretohet se të drejtën e disponon çdokush që pretendon se titulli si trashëgimtar i është mohuar njësoj siç dhe interpretimi i nenit 349 nxjerr në pah. Objekti në ligjin civil italian lidhur me padinë për kërkimin e trashëgimit, është njohja e cilësisë dhe dorezimi i sendit pasuri trashëgimore dhe objekt gjykimi. Një ndryshim që vërehet midis padisë për kërkimin e trashëgimit për ligjin italian dhe atë shqiptar, është pikërisht që dispozita e ligjit italian nuk e parashikon dorëzimin e sendit ndërsa ligji shqiptar e parashikon. Megjithatë, të dy legjislacionet parashikojnë kërkimin e pasurive të përfituara nga trashëgimia si në mirëbesim dhe në keqbesim.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm i kësaj padie është dhe legjitimi pasiv dhe aktiv. Legjislacioni italian e parashikon se kërkesën dhe legjitimitetin e ka çdokush që posedon pasurinë me titull trashëgimie apo pa një të tillë. Në këtë pikë legjislatori shqiptar është shkëputur nga legjislacioni italian, duke mos e përfshirë si opcion posedimin e titullit të trashëgimisë. Si një padë reale, padia për kërkimin e trashëgimit mund të drejtohet dhe ndaj palëve të treta, gjë e cila në legjislacionin tonë është jo shumë e dukshme por që në praktikë konsiderohet si e aplikueshme (Manuale del diritto privato italiano, , 1996, p. 574). Për sa lidhet me marrëdhëniet dypalëshe, Kodi Civil shqiptar, parashikon se në rastet kur kjo pasuri është poseduar nga një person i tretë i cili e ka fituar me mirëbesim dhe kundrejt një kundërshtëpërblimi nga trashëgimtari, atëherë personi posedues nuk është i detyruar të kthejë pasurinë tek trashëgimtari pretendues. Dallimi ndërmjet dy legjislacioneve është se ligji italian nuk parashikon kundërshtëpërblimin si kusht për rikthimin e pasurisë por duhet të ekzistojë elementi i mirëbesimit. Ligji italian lidhur me mirëbesimin, parashikon rastet kur personat e tretë tjetërsojnë pasurinë në mirëbesim dhe se si duhet të veprojnë ky person në raport me trashëgimtarin pretendues. Kur pasuria është tjetërsuar në mirëbesim, legjislacioni shqiptar dhe italian parashikon se personi i tretë kthen vetëm çmimin apo çmimin e marrë.

4.2. Padia per kerkimin e trashegimit sipas legjislacionit francez

Trashëgimia ligjore në Francë është një përcaktim ligjor e cila specifikon ndarjen e një pjesë të pasurisë së një personi të vdekur (trashëgimlënësi) të trashëgohet automatikisht nga

trashëgimtarët e tij/saj. Ligji i trashëgimisë ligjore në Francë ka ekzistuar që në periudhën e Napoleonit dhe kishte si qëllim parandalimin e përjashtimit të fëmijëve nga trashëgimia. Ky ligj synonte që fëmijët të trashëgonin 50-77% të një pasurie. Me këtë ligj siç dhe u tha më sipër, u bë e pamundur përjashtimi i fëmijëve nga trashëgimia. Legjislatori francez nëpërmjet këtij ligji, garanton që fëmijët të marrin një pjesë të pasurisë në mos të marrin të gjithën. Në rastet kur një nga trashëgimtarët vdes përpara prindërve, atëherë ligji francez i njeh të drejtën nipërve dhe mbesave për të qenë trashëgimtarët e tyre.

Krahas këtyre faktoreve, ligji francez lejon dhe pretendimin e një pasurie trashëgimore ndaj një personi që nuk jeton brenda kufinjve territorial të Francës (France Succession Law, French Supreme Court rules out forced heirship, 2021). Edhe pse Franca e njeh trashëgiminë ligjore, nuk njeh padinë për kërkimin e trashëgimit si formë e një mjete mbrotjës të të drejtave të trashëgimtarit. Megjithatë, jurisprudenca franceze ka dhënë përkufizimin personal për padinë për kërkimin e trashëgimit. Sipas saj, kjo padi përkufizohet si *“mjete ndërmjet të cilit një trashëgimtar kërkon t’i njihet cilësia e tij, me qëllim që më pas të kërkojë të gjithë ose një pjesë të pasurisë trashëgimore të mbajtur nga një i tretë, i cili e posedon këtë pasuri duke pretenduar se është vetë trashëgimtar”* (Jacques Flour, Henri Souleau Les Successions, p. 149). Sipas doktrinës franceze, kjo padi është një padi reale pasi në karakterin e saj objekti është kërkimi i pasurisë trashëgimore dhe pasoja që vjen është kalimi i pasurisë nga trashëgimtari që e posedonte tek trashëgimtari që j’u mohua e drejta (Jacques Flour, Henri Souleau, 1982). Një dallim tepër i veçantë midis legjislacionit italian, shqiptar dhe atij francez qëndron tek fakti që padia për kërkimin e trashëgimit në legjislacionin francez parashkruhet brenda 30 (tridhjetë) vjetësh ndërsa në legjislacionin civil shqiptar dhe italian kjo padi nuk parashkruhet.

Shteti francez lidhur me institutin e trashëgimisë aktualisht ka dy diskutime kryesore. Së pari është momenti kur do të nis afati i parashkrimit, a do të konsiderohet momenti i vdekjes së trashëgimlënësit apo kur ajo sjell efektet dhe trashëgimtari fillon të sillet si trashëgimtar i pronësisë së kaluar (Padia për kërkimin e trashëgimit dhe praktika gjyqësore në lidhje me të, 2022). Dhe diskutimi i dytë qëndron tek hipoteza që këtë padi mund t’a ngrejë dhe një trashëgimtar që nuk thërritet në trashëgim, kur të afërmit e personit inaktiv, janë trashëgimtar të denjë, thërriten dhe nuk ushtrojnë të drejtën e padisë për kërkimin e trashëgimit (Les Successions Les Liberalites, 1995-1996, p. 155).

Lidhur me efektet e kësaj padie, personat e trete që kanë perfituar nga perdorimi i kesaj pasurie perفشire këtu dhe përfitimin e sendeve, brenda kushteve të mirëbesimit, nuk janë të detyruar

të kthejnë sendet, për më tepër nëse ato janë përfituar kundrejt një kundërshpërblimi. Risi e legjislacionit francez është që kundërshpërblimi mund të jetë në para ose me tituj të veçantë. Në ligjin francez civil, përparësi në mbrojtje nga ligji ka trashëgimtari paditës që pretendon njohjen e cilësisë si i tillë.

Neni 350 i Kodit Civil shqiptar, parashikon që personi disponues i pasurisë përveç elementit të mirëbesimit dhe kundërshpërblimit, ai duhet t'a disponojë atë në bazë të një dëshmie trashëgimie dhe përsa kohë ekzistojnë këto faktorë, personi i tretë nuk është i detyruar të kthejë sendin.

Nëse do bëhet një krahasim i legjislacioneve, lidhur me sa u shpreh për marrëdhënien me të tretët, shihet se në raport me legjislacionin italian, kundërshpërblimi nuk ishte një element i domosdoshëm por parimi i mirëbesimit ishte. Ndërsa në legjislacionin francez, parimi i mirëbesimit nuk është një element i domosdoshëm. Kodi Civil shqiptar, i kërkon të dyja elementet të jenë prezent në mënyrë që të përjashtohet nga kthimi i sendit (Les Successions Les Liberalites, 1995-1996).

4.3 Padia për kërkimin e trashëgimit sipas legjislacionit gjerman.

E drejta trashëgimore në Gjermani është në linja të ngjashme me të gjithë sistemin “Civil Law”. Përpilimi i një dokumenti testamentar sipas legjislacionit gjerman mund të bëhet vetëm në 2 forma, me anë të testamentit të shkruar dhe me anë të testamentit publik. Legjislacioni gjerman ka të veçantë faktin se mosha e lejuar për të hartuar një testament është që nga mosha 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeçare ose më shumë dhe duhet të jetë i shkruar me dorë nga fillimi deri në fund dhe të jetë i nënshkruar nga trashëgimlënësi. Kur trashëgimia ka mangësira të cilat janë shkaktuar nga shkrimi i testamentit me anë të kompjuterit, ose nëse nënshkrimi mungon ose trashëgimia është diktuar (e rregjistruar me anë të kasetës), atëherë trashëgimia testamentare konsiderohet e pavlefshme dhe si rrjedhojë vetëm trashëgimtarët ligjore mund të trashëgojnë nga pasuria nëse nuk ekziston një testament tjetër i vlefshëm që jep një emërtim alternativ. Bazuar në ligjin gjerman të trashëgimisë, vetëm të afërmit klasifikohen si trashëgimtarë të cilët janë, persona me prindër të njëjtë, gjyshër të njëjtë ose stërgjyshër të njëjtë si trashëgimlënës si dhe personat që ndajnë shumë paraardhës të përbashkët me trashëgimlënësin (E-Justice, European Justice, Succession in Germany, 2023, p. 1).

Sipas rregullit standard, vdekja e trashëgimlënësit është momenti i çeljes së trashëgimisë. Si rrjedhojë, sipas ligjit gjerman të trashëgimisë, një dokumentacion “*mortis causa*” i paraqitur në gjykatën e verifikimit, do të hapet zyrtarisht nga kjo gjykatë menjëherë pas vdekjes së trashëgimlënësit. Për këtë moment, trashëgimtarët do të njoftohen. Një element shumë i rëndësishëm karakterizues i legjislacioneve europiane është pikërisht dhe disponimi i “çertifikatës së trashëgimisë” e cila i ofron lehtësi trashëgimtarëve në provimin e cilësisë së tyre si trashëgimtarë. Çertifikata e trashëgimisë lëshohet nga gjykata e verifikimit (Probate Court) dhe specifikon:

- a. Kush është ose janë trashëgimtari/arët
- b. Shtrirja e të drejtave së tij/saj trashëgimore si dhe
- c. Sipas rastit mund dhe të parashikojë një trashëgimi pasues ose ekzekutimin e trashëgimisë.

Kjo gjykatë lëshon çertifikatën e trashëgimisë sipas kërkesës të bërë nga trashëgimtarët ligjore. Aplikanti duhet të demonstrojë se detajet e kërkuara nga ligji janë të gjitha të sakta ose ofrojnë një deklaratë statutore për të treguar se nuk ekziston një arsye për të dyshuar në saktësinë e detajeve. Deklarata statutore mund të hartohet me kërkesën e trashëgimtarëve përpara një noteri ose një gjykate, përveçse kur ligji i një shteti federal përcakton se këtë të drejtë e ka vetëm noteri.

Nëse do të flitet për pjesën më të rëndësishme të procedurës trashëgimore e cila është ndarja e pasurisë trashëgimore, shteti gjerman ka bërë përcaktime lidhur me rrugën që do të ndiqet për të bërë këtë ndarje. Nëse një pasuri trashëgimore ka shumë trashëgimtarë, ajo bëhet pronë e përbashkët e bashkëtrashëgimtarëve, pra në linja të ngjashme me ligjin shqiptar, ata do të bëhen bashkëpronarë. Si rezultat, bashkëtrashëgimtarët janë të lejuar të disponojnë vetëm pjesën individuale të marrë nga kjo shpërndarje dhe ky disponim duhet bërë duke vepruar bashkarisht. Ligji gjerman gjithashtu kërkon që menaxhimi i trashëgimisë të bëhet bashkarisht. Teorikisht, ky qëndrim i legjislatorit gjerman, është tepër i ashpër pasi e drejta e disponimit të pronësisë si një e drejtë individuale duhet t’i japi hapsirën trashëgimtarëve të vepronë sipas dëshirës dhe të drejtave të tyre dhe jo të jenë të detyruar të bëjnë menaxhim të përbashkët. Për këtë arsye, kjo shkakton problematika dhe vështirësi të mëdha, veçanërisht nëse trashëgimtarët jetojnë në vende të largëta dhe nuk kanë një dakordësi me njëri tjetrin. Kjo “marrëveshje e detyruar” që përban një grupim personash që janë të detyruar nga ligji të jenë të ndërlidhur me njëri-tjetrin, është shumë e papërshtatshme dhe në parim çdo

trashëgimtar mund të kërkojë shpërbërjen e bashkësisë duke kërkuar ndarjen e pasurisë. Ligji gjerman për kërkesën e ndarjes së pasurisë i jep mundësinë trashëgimtarëve që të caktojnë, për ndarjen e pasurisë një përmbarues. Në të kundërt kjo ndarje bëhet nga trashëgimtarët vetë. Për të realizuar këtë qëllim, ata kanë të drejtën të kërkojnë një noter si rrugën e fundit të ndihmës së tyre. Dhe kur sërisht palët kanë mosmarrëveshje dhe noteri nuk shihet me si një alternativë atëherë mundësia e fundit është ndërmarrja e veprimeve ligjore (E-Justice, European Justice, Succession in Germany, 2023). Në fund të procedurave trashëgimore, kërkohet një certifikatë trashëgimie ose një Çertifikatë Europiane e trashëgimisë për të vërtetuar se trashëgimtari ka një të drejtë trashëgimie për rastet si psh kur trashëgimtari dëshiron një pjesë të një toke ose një llogari e mbajtur në emër të trashëgimlënësit të transferohet në emrin e tij (E-Justice, European Justice, Succession in Germany, 2023).

4.3.1. Padia për kërkimin e trashëgimit në aspektin krahasimor me Shqipërinë.

Padia për kërkimin e trashëgimit parashikohet nga Kodi Civil gjerman si një mjet mbrojtës i të drejtës trashëgimore të trashëgimtarëve. Nëse pronësia trashëgimore posedohet tërësisht nga një trashëgimtar jo real, atëherë legjislacioni gjerman i ofron mundësinë trashëgimtarit të vërtetë të përdori mjetin mbrojtës të padisë për kërkimin e trashëgimit për të kërkuar rikthimin e të gjithë pronësisë ose të disa sendeve të veçanta (Family & Succession Law in Germany, 2001, p. 147). Padinë për kërkimin e trashëgimit sipas legjislacionit gjerman, ashtu si dhe në legjislacionin shqiptar, mund ta ngrejë çdo bashkëtrashëgimtar, i cili kërkon gjithë pasurinë trashëgimore, me kusht që pjesët të ndahen dhe t'iu dorëzohen më pas pjesët takuese gjithë bashkëtrashëgimtarëve të tjerë.

Sipas legjislacionit civil gjerman, paditës për këtë padi është personi trashëgimtar që pretendon cilësinë si i tillë për pasurinë trashëgimore ose për sende të saj por mund të jenë dhe trashëgimtarë që pretendojnë se janë trashëgimtarë të vetëm të të gjithë pasurisë, duke mohuar cilësinë e trashëgimtarit bashkëtrashëgimtarëve të tjerë (Family & Succession Law in Germany, 2001, p. 147). Në ndryshim nga legjislacioni ynë dhe ai italian e francez, legjislacioni gjerman e ndalon ngritjen e padisë për trashëgimin ndaj personave të tretë që posedojnë një pjesë apo një send të kësaj pasurie por jo me cilësinë e trashëgimtarit.

Objekti i kësaj trashëgimie është i njëjtë me objektin që legjislacioni shqiptar parashikon për këtë padi, pra dorëzimi i pasurisë tek trashëgimtarët legjitim.

4.4 Instituti i trashëgimisë sipas legjislacionit grek.

Në legjislacionin grek, forma më e trajtuar e trashëgimisë është ajo vullnetare, pra trashëgimia testamentare. Sipas neneve 1710 dhe 1712 të Kodit Civil grek, trashëgimia vullnetare është e mundur vetëm nëpërmjet testamentit. Format më të zakonshme që analizon legjislacioni grek janë:

a. Testamentet e zakonshme:

Testamenti, me datën, vendin dhe emrin dhe mbiemrin e trashëgimlënësit sëbashku me nënshkrimin e tij është forma e testamentit të zakonshëm. E veçanta e legjislacionit grek qëndron tek fakti që ky testament nuk është i detyrueshëm të dorëzohet pranë ndonjë autoriteti. Çelja e këtij testamenti bëhet menjëherë pas vdekjes së trashëgimlënësit nga personi që disponon testamentin, pa asnjë vonesë të qëllimshme, pranë Gjykatës së Rrethit ku i ndjeri ka pasur banesën e fundit ose për rastet kur ai ndodhet jashtë territorit grek, pranë çdo konsullate të vendit ku ka vdekur apo ka qenë rezident.

Testamenti i vulosur, hartuar nga trashëgimlënësi dhe dorëzohet pranë noterit në një zarf të vulosur dhe të mbyllur. Kjo procedurë sipas Kodit Civil grek, ndodh në prani të një noteri dhe tre dëshmitarëve ose në prani të dy notereve dhe një dëshmitari. Me vdekjen e trashëgimlënësit, noteri duhet, pa ndonjë vonesë të qëllimshme, të depozitojë kopjen origjinale pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku noteri ka zyrën e tij.

Testamenti pubik, është një formë e testamentit të zakonshëm që shpallet përpara një noteri në prani të tre dëshmitarëve ose në prani të dy notereve dhe një dëshmitari. Me anë të kësaj shpalljeje, noteri harton një deklaratë noteriale e cila përmban testamentin e trashëgimlënësit. Pas vdekjes, procedura që ndiqet është e njëjtë si për testamentin e vulosur (Sucession in Greece, 2003).

E veçanta e legjislacionit grek qëndron dhe tek përcaktimi i hartimit të testeve të “jashtëzakonshme” të cilat lejohen vetëm në kushte të atilla. Shëmbulli që trajtohet nga Kodi Civil grek është kur ky testament hartohet në bordin e një anijeje nga ushtarakët apo të izoluarit. Ky testament në momentin e hartimit dërgohet në konsullatën më të afërt greke ose në një zyrë noteriale në Greqi nga ku do të njoftohen autoritetet kompetente greke. Megjithatë, kjo formë e testamentit bëhet e pavlefshme (null and void) në momentin kur

kanë kaluar tre muaj nga momenti kur këto rrethana të jashtëzakonshme pushuan së paturi efekt dhe trashëgimlënësi është akoma gjallë.

Lidhur me kompetencën që autoritetet kanë për një trashëgimi të lënë nga një shtetas grek, kryesorja e përcaktuar në legjislacionin grek është pikërisht gjykata e “Trashëgimisë” ose Gjykata Civile e Rrethit ku trashëgimlënësi ka pasur banesën e fundit ose Gjykata e Kryeqytetit për rastet kur mungon rezidenca e fundit e trashëgimlënësit. Krahas gjykatave, legjitimohen noteret dhe autoritetet tatimore për të marrë deklarata tatimore të trashëgimisë dhe për të vendosur tatime për pasurinë trashëgimore.

4.4.1 Aspekte krahasimore me legjislacionin shqiptar.

Legjislacioni grek ka bërë një përfshirje të gjerë lidhur me institutin e trashëgimisë. Përsa i përket padisë për kërkimin e trashëgimit, si rrjedhojë e një rregullimi mjaft të mirë që është bere për trashëgiminë, dhe padia për kërkimin e trashëgimit përfshihet si mjet mbrojtës i të drejtës trashëgimore të trashëgimtarit. Neni 1871 përkufizon padinë për kërkimin e trashëgimit në kontekst të ngjashëm me legjislacionin shqiptar, duke u shprehur se padia për kërkimin e trashëgimit është një e drejtë e trashëgimtarit për të kërkuar nga personi cili e mban pa një të drejtë dhe duke pretenduar se është trashëgimtar, objekt të pasurisë apo vetë pasurinë trashëgimore si dhe njohjen e të drejtës për të trashëguar dhe dorëzimin e pasurisë ose vetëm një pjesë të veçantë të saj (Αστικός Κώδικας, 1946). Kjo dispozitë krahas përshkrimit të atij elementi që lidhet me thelbin e padisë për trashëgimin, nxjerr në pah dhe legjitimitetin aktiv, pra kush legjitimohet të ngrejë këtë padi dhe objektin e saj. Si objekt, sipas nenit vijues të Kodit Civil grek, objekt i padisë krahas objektit kryesor, mund të jetë:

1. Ato mbi të cilat trashëgimlënësi në kohën e vdekjes kishte të drejtë pronësie apo posedimi por që për gjatë periudhës që ishte gjallë nuk i kishte parashikuar;
2. Gjithshka e ardhur si rezultat i veprimeve juridike që pala e paditur e ka mbajtur nën cilësinë (mendimit) të trashëgimtarit.

Pasojat që rrjedhin nga ngritja e kësaj padie janë të ngjashme me ato të parashikuara në nenin 352 të Kodit Civil shqiptar. Sipas dispozitave vijuese (1873-1875) të legjislacionit civil grek, krahas të tjerave, trashëgimtarit paditës, i padituri ka të drejtën t’i kërkojë dhe shpenzimet e kryera nga ky i fundit për të shlyer detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore. Siç dhe vërehet legjislacioni civil grek, ka dimensione të ndryshme të cilat pasqyrohen jo vetëm

tek format e shumta të testamentit që ligji lejon por dhe në lidhje me parashkrimin fitues mbi këtë padi. Sipas nenin 1879 të Kodit Civil grek, pasuria trashëgimore jo vetëm që mund të fitohet me parashkrim (pra parashkrimi fitues lejohet) por poseduesi i trashëgimisë pas kalimit të kohës, nuk mund të pretendojë se pronësinë e ka fituar me anë të parashkrimit fitues, nëse padia për kërkimin e trashëgimit deri në atë moment nuk është parashkruar. Kjo nënkupton që jo vetëm që parashkrimi fitues nuk shuan të drejtat subjektive të kerkuesit (trashëgimtarit pretendues) por plotësimi i afatit të parashkrimit sjell automatikisht fitimin e pasurisë. Ky është elementi dallues midis legjislacionit grek dhe atij shqiptar.

Kodi Civil grek, gjithashtu në ndryshim nga legjislacioni shqiptar, kërkon dhe detyrimin e informacionit që i padituri, posedues i pasurisë, t'ja ofrojë trashëgimtarit real lidhur me gjendjen e pronësisë apo sendit objekt padie dhe fatin e objekteve të tyre. Të njëjtin detyrim ka dhe kushdo i cili pa patur cilësinë si trashëgimtar, merr në posedim sendin nga pasuria trashëgimore si dhe kushdo që në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit ka bashkëjetuar me të në të njëjtën banesë. Legjislacioni grek në mënyrë direkte përfshin si pjesë të palëve që mund të paditen dhe palët të cilët kanë përfituar në mirëbesim pasurinë dhe nëpërmjet kontratës që mund të kenë lidhur. Legjislacioni shqiptar ashtu si dhe legjislacioni grek, specifikon se nëse kjo pasuri nuk është fituar me mirëbesim ose kundrejt një kundërshpërblimi, atëherë i padituri ka detyrimin t'i kthejë sendin trashëgimtarit real e cila realizohet ligjërisht vetëm nëpërmjet padisë për kërkimin e trashëgimit (Padia për kërkimin e trashëgimit dhe praktika gjyqësore në lidhje me të., 2022).

Kodi Civil grek, në ndryshim nga legjislacionet e përmendura, parashikon se këtë padi mund t'a ngrejë dhe një trashëgimtar i cili ishte shpallur i zhdukur por rezulton se është gjallë (Αστικός Κώδικας, 1946).

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.

Instituti i trashëgimisë është instituti më i gjerë ku krahas tij, instituti i padisë për kërkimin e trashëgimit është më pak i prekuri. Sipas Kodit Civil trashëgimia është shpërndarja e pronësisë së trashëgimlënësit (të vdekurit), midis personave të listuar me ligj dhe/ose testament (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 2014). Për këtë institut, doktrina ka bërë analiza të gjera, por për padinë për kërkimin e trashëgimit ka mangësira. Historiku është mjaft i pasur në fillimet e saj në periudhën e drejtës romake, por në vijim me periudhën e Mbretërisë së Shqipërisë ku influencë shumë të madhe ka pasur e drejta zakonore kjo padi vijonte të kishte themele të forta. Në periudhën komuniste ku e drejta private shuajti se ekzistuari, shtetasit nuk kishin më një mjet mbrojtës për kërkimin e të drejtës themelore të tyre. Në Kodin Civil modern, legjislatori ka parashikuar dispozita të shumta lidhur me mënyrën e fitimit të pasurisë nëpërmjet trashëgimisë por lidhur me padinë për kërkimin e trashëgimit ka qenë e limituar në 3 nene. Procedura civile më tepër analizon mënyrën dhe format e ngritjes së padisë në tërësi dhe legjitimitetin gjyqësor.

Gjatë periudhës së të drejtës romake, padia për kërkimin e trashëgimit njihej me termin latin “hereditatis petitio” dhe kjo padi ngrihej për çdo rast kur trashëgimtarit ose disa prej trashëgimtarëve u ishte mohuar e drejta e tyre për të qenë pjesmarrës në trashëgimi. Për rastet kur provohej prej këtyre të fundit se ishin pjesë faktike e trashëgimisë apo posedues të atij sendi trashëgimorë, atëherë gjykata i ofronte mundësinë që të merrej ose e gjitha pjesë e trashëgimisë ose ajo pjesë për të cilën pretendohesh se ishte mohuar e drejta e tyre. Specifike për këtë periudhë ishte elementi i parashkrimit. Padia për kërkimin e trashëgimit në periudhën romake në ndryshim me periudhat pasardhëse, nuk parashkruhej me argumentin se kjo ishte një padi e përhershme. Pra, trashëgimtari do të ishte gjithmonë trashëgimtar pavarësisht periudhës kohore që mund të kishte kaluar. Me zhvillimin e qytetërimit dhe me aksesin më të madh të informacionit, zhvillimi për padinë për kërkimin e trashëgimit pësoi disa periudha tranzitore. Gjatë periudhës së Mbretërisë, padia u influencua nga e drejta

zakonore, një rryme e cila iniconte stilin patriarkal të organizimit shtetëror. Gjatë periudhës komuniste, shteti shqiptar shuajti të drejtën e individëve për të qenë të lirë të kishin një pronë private. Në rastin e mohimit të kësaj të drejte, t'i drejtoheshin gjykatës shihej si e pamundur. Për të diskutuar, ka pasur mjaftueshëm pasi teorikisht si institut ekzistonte, por praktika gjyqësore nuk e trajtonte marrëdhënien mes privatëve por marrëdhënien ku shteti ishte pronari suprem.

Periudha moderne dhe krahasuar me legjislacionet e rajonit, solli risi dhe ndryshime nga periudhat paraardhese. Parashkrimi për këtë padi në Shqipëri nuk lejohej dhe e drejta për të ngritur këtë padi i'u dha çdo personi të cilit i'u mohua cilësia si trashëgimtar dhe kërkonte pjesën e mohuar. Në legjislacionin grek aspekti testamentar është më i trajtuar se trashëgimia ligjore ashtu si dhe në Gjermani, Francë dhe Itali e cila tregon rëndësinë që legjislatori i kushton vullnetit të lirë të individëve. Megjithatë, në thelb këto legjislacione përputhen në elementet e objektit të padisë, palëve që janë të legjitimuara të ngrejne padinë dhe të paditen, marrëdhënien me të tretët dhe kompesimi në këto raste. Praktika gjyqësore gjithashtu ka analizuar në unifikimin e praktikës së saj, dhe rastet që për shkak të mostrajtitimit të saktë të kësaj padie, kanë krijuar probleme. Siç është dhe padia për kërkimin e rivendikimit e cila shpesh herë ngrihet si padi për kërkimin e trashëgimit. Në analizën e bërë të gjykatës, kjo e fundit ka sqaruar se cilat janë kushtet për ngritjen e kësaj padie dhe se si kjo padi është mjet për mbrojtjen e të drejtave trashëgimore.

Bazuar në kërkimin e mësipërm, vërejtjet mëposhtme mund të bëhen:

- Padia për kërkimin e trashëgimit është e një rëndësie të madhe për shkak të mbrojtjes që i bën një prej formës së tjetërsimit të pasurisë.
- Në vendin tonë ka mangësira të shumta pasi legjislacioni ka qenë inkoherent dhe jo i qëndrueshëm. Është ndryshuar në mënyrë të vazhdueshme dhe kjo ka sjellë paqartësi në hartimin e dispozitave.
- Legjislacionet ndërkombëtare janë të qëndrueshme për shkak se kanë konsoliduar zhvillimin historik të institutit së bashku me zhvillimin që ka pësuar kjo padi dhe ka konsoliduar praktikën dhe për këtë arsye është më e qartë që dhe problematika gjyqësore ka qenë më e ulët.

- Praktika gjyësore shqiptare nuk është e qartë në kuptimin e objektit që lidhet me padinë për trashëgimin dhe për këtë arsye konfuzohet me padinë për kërkimin e rivendikimit.

Në mënyrë që Shqipëria të harmonizohet me legjislacionet ndërkombëtare civile dhe që gjykatat të shmangin procedura gjyqësore të dështuara pasi efekti negativ bie jo vetëm tek palët e afektuara por dhe tek shtetasit shqiptar për shkak të detyrimeve tatimore. Si rrjedhojë rekomandimet që ngrihen janë:

- Shtimi i dispozitave në Kodin Civil shqiptar lidhur me padinë për kërkimin e trashëgimit. Mungesa e theksuar e dispozitave krahasuar me legjislacionin italian është dhe arsyeja përse ekzistojnë problematika dhe në praktikë dhe si rrjedhojë duhet korrigjuar.
- Përfshirja në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë elementet e padisë për kërkimin e trashëgimit, objektin që ka dhe palët që legjitimohen.
- Unifikimi i praktikës së Gjykatës së Lartë në mënyrë korrekte dhe të qartë jo vetëm për Gjykatat e shkallëve më të ulëta por dhe për personat që aksesojnë vendimarrjet e Gjykatës së Lartë.

REFERENCES

Italian Inheritance Law, A Brief Guide for Foreigners. (2022). Milano: The Italian Lawyer.

Vendim nr.4335, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane. (2004).

(Vendim Nr.123, date 09.03.1970, Drejtësia Popullore, Nr.3,. (1979). Tiranë.

(Vendim Nr.6054, Gjykata e Rrethit Tiranë. (1996).

Bicoku. (n.d.).

Codice Civile. (1942). *Libro Secondo, Titolo I, Delle Successioni.* From <https://www.altalex.com/documents/codici-altalex/2015/01/02/codice-civile>

Dekret Nr.1892 "Mbi Trashëgiminë". (1954). Tiranë: Parlamenti Shqiptar.

Droit prive romain, II, Obligations, Successions, Procedure , "CJR". (1991). Lausanne: Brian Schmidlin, Carlo Augusto Cannata.

E Drejta e Trashëgimisë e R.P.S.SH. (1984). Tiranë: Parlamenti i Republikës Popullore Socialiste Shqiptare.

E Drejta Romake (Vol. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës). (2015). Prishtinë: Ivo Puhan.

E Drejta Zakonore Shqiptare (Vol. i parë). (1989). Tiranë.

E-Justice, European Justice, Succession in Germany. (2023). Bruksel: European Union.

Family & Succession Law in Germany. (2001)

France Succession Law, French Supreme Court rules out forced heirship. (2021).

How to challenge an Italian Will. (2022). Milano: VGS Family Lawyers.

Jacques Flour, Henri Souleau. (1982).

Jacques Flour, Henri Souleau Les Successions. (n.d.).

Kodi Civil. (1981).

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. (2016). Tiranë: Parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

Kodi Civil R.P.S.SH. (1982). Tiranë: Parlamenti i Republikës Popullore Socialiste Shqiptare.

Kodi Civil Shqiptar. (1929).

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, Nr.36, . (1956).

Les Successions Les Liberalites. (1995-1996).

Les Successions Les Liberalites. (1995-1996).

Mandro, A. (1998). *E Drejta Romake.* Tiranë: Afërdita.

Manuale del diritto privato italiano, . (1996).

My lawyer in Italy, Inheritance law. (2023).

Neni 19 L.T, Padia per Kerkimin e Trashegimise. (1958).

Neni 533, Volumi i II, Kapitulli IX, Kodi Civil Italian. (1946).

Padia për kërkimin e trashëgimit dhe praktika gjyqësore në lidhje me të,. (2022).

Palët dhe legjitimiteti i pjesmarrësve në procesin civil (Vols. Trajtime Juridike, Julvin). (2002). Tiranë: Dashamir Kore.

Petition for an Inheritance, a way to protect hereditary rights. (2009).

Principle of Universal Succession. (2023). From <https://www.german-probate-lawyer.com/en/glossary/def/principle-of-universal-succession-germany.html>

Procedura Civile (Cikel Leksionesh). (2002). Tiranë: Vitore Tusha, Flutra Tafaj.

Procedura Civile e R.P të Shqipërisë. (2017). Parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

Puhan, I. (2015). *E Drejta Romake* (Vol. i pestë). Prishtinë, Kosovë.

Shkolla e Magjistraturës. (2010). Tiranë: Artan Hajdari-Petagog.

Sucession in Greece. (2003). Bruksel: European Union.

Udhëzim i Pleniumit të Gjykatës së Lartë Nr.6. (1956).

Udhëzim Nr. 6. (1956).

Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. (1971-1973).

Vendim Nr. 2844, Gjykata e Rrethit Tiranë. (1996).

Vendim Nr. 6238, Gjykata e Rrethit Tiranë. (1996).

Vendim Nr. 73, datë 16.06.1931, Gjyqi i Diktimit (Vol. 8). (1931). Tiranë: Jurisprudencia Shqiptare.

Vendim Nr.1466, Gjykata e Rrethit Tiranë. (1998).

Vendim Nr.19 i Kolegjeve të Bashkuara. (2002). Tirane: Gjykata e Larte.

Vendim Nr.230. (2003). Tirane: Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

Vendim Nr.4, . (1994). Tiranë: Gjykata Kushtetuese.

Vendim Nr.5167, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. (2004).

Vendim Nr.697, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. (2006).

Vendim Unifikues Nr.5. (2011). Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

Vendimi nr.4463, Gjykatës së Rrethit Tiranë. (1996).

Vendimi Nr.6 i Kolegjeve të Bashkuara. (2007). Tirane: Gjykata e Larte.

Αστικός Κώδικας. (1946). Athens: Greek Parliament.

Αστικός Κώδικας,. (1946). From <https://www.lawspot.gr/nomikes-plirofories/nomothesia/astikos-kodikas>

CURRICULUM VITAE

Paula Ndroqi ka lindur në 13 qershor 1999 në Tiranë, Shqipëri. Ajo ka nisur studimet në degën Drejtësi pranë Universitetit Epoka në 15 tetor 2018 dhe këtë vit përfundon ciklin 5 vjecar të integruar të studimeve. Përgjatë këtyre viteve, ka qenë pjesë e shumë trajnimeve të ofruara nga Universiteti Epoka si dhe ka qenë pjesë e trajnimeve jashtë shkollore. Në fillimet e studimeve të saj, ka qënë pjesë e trajnimeve pranë një zyre noteriale dhe pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë. Në vitin 2022 ndoqi një praktikë 3 mujore pranë Deloitte Legal. Aktualisht, krahas praktikës së ndjekur në studion ligjore “Rakipi and Partners”, është e punësuar si asistente ligjore virtuale për studion ligjore në New York, “Berkovitch and Bouskila” duke asistuar në procedura të ndryshme lidhur me shërbimin ndaj të paditurve.